



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No (1/Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No. 04/141 Nr. ifaq./Br./Br./No.pg 88

Data/Datum/Date 29.05.2026

Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja f) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2013"), Risihikimit të Strategjisë Shtetërore për Ujërat 2023-2027 dhe Plani i Veprimit 2023-2025 dhe nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.6 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.05.2026, miraton këtë:

V E N D I M

**Për miratimin e Strategjisë për Menaxhimin e Ujërave të Zeza në Komunën e Rahovecit
2025 - 2031**

1. Me këtë vendim, **miratohet** Strategjia për Menaxhimin e Ujërave të Zeza në Komunën e Rahovecit 2025 - 2031.
2. Shtojcë e këtij vendimi është edhe Strategjia për Menaxhimin e Ujërave të Zeza në Komunën e Rahovecit 2025 - 2031.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenit 8 dhe nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Shërbimit të Kuvendit,
- Drejtorisë për Shërbime Publike,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.141/26
Datë:29.05.2026





Republika Kosovo
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Skupština opštine Rahovec
Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No. 111 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No. 01/141 Nr. ifaq./Br.str./No.pg. 98

Data/Datum/Data 29.05.2026

Na osnovu člana 12. tačka 1. i 2. lit. d), člana 17. tačka f) i člana 40. Zakona broj 03/L-040 o lokalnoj samoupravi ("Službeni list Republike Kosovo br. 28/2008"), odredbe Zakona br. 04/L-147 o vodama Kosova ("Službeni list Republike Kosovo, broj 10/2013"), Ponovnog Razmatranja Državne Strategije za Vode 2023-2027. i Akcionog plana 2023-2025. i člana 10. stav 2. tačka 2.4, člana 40. i člana 57. stav 1. tačka 1.6 Statuta opštine Orahovac, broj 1005, od 29.3.2017. godine, Skupština opštine na sjednici održanoj 29.05.2026. godine donosi:

ODLUKU

Za usvajanja Strategije upravljanja otpadnim vodama u opštini Orahovac 2026 - 2031.

1. Ovom odlukom **usvaja se** Strategija upravljanja otpadnim vodama u opštini Orahovac 2026 - 2031.
2. U prilogu ove odluke je i Strategija upravljanja otpadnim vodama u opštini Orahovac 2026 - 2031.
3. Za sprovođenje ove odluke staraće se Predsednik opštine i odeljenje za javne usluge.
4. Nakon usvajanja od strane Skupštine opštine Orahovac, ova odluka stupa na snagu 30 dana nakon dostave nadzornom organu, u smislu člana 8., u vezi sa članom 9. Zakona br. 08/L-284 o upravnom razmatranju akata opštine, članom 8. i članom 9. Uredbe (VRK) br. 02/2026 o postupku upravnog razmatranja akata opštine i 7 dana nakon javne objave na oglasnoj tabli ili zvaničnoj internet stranici opštine.

Odluku dostaviti:

- Skupštinskoj Službi,
- Odeljenju za javne poslove,
- MALS, i
- Arhivi.

SKUPŠTINA OPŠTINE ORAHOVAC

01-Nr.141/26
Dana: 29.05.2026


Fatmir Iska
Predsedavajući Skupštini



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec

Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly of Rahovec



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No. 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No. 91/141 Nr. i faq./Br.shr./No. pg. 88

Data/Datum/Date 29.05.2016

STRATEGJIA PËR MENAXHIMIN E UJËRAVE TË ZEZA
NË KOMUNËN E RAHOVECIT
2026 – 2031

STRATEGY FOR WASTE WATER MANAGEMENT
IN THE MUNICIPALITY OF RAHOVEC

2026 – 2031

Maj, 2026

Përmbajtja:

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	8
1.1 Konteksti dhe problemi kryesor	8
1.2 Objektivi strategjik	8
1.3 Ndërhyrjet kryesore	8
1.4 Kostoja dhe fazat e zbatimit.....	8
1.5 Institucionet përgjegjëse	9
2. HYRJA.....	10
2.1 Lidhja me dokumentet strategjike dhe korniza ligjore.....	10
2.2 Qëllimi dhe dimensionet e strategjisë	11
2.3 Fokuset operationale të strategjisë	11
2.4 Metodologjia.....	11
2.5 Vizioni	12
2.6 Misioni.....	12
3. ANALIZA E GJENDJES	12
3.1 Të dhënat e përgjithshme dhe pozita gjeografike	12
3.2 Klima.....	14
3.3 Demografia.....	14
3.4 Ekonomia	17
3.5 Bujqësia dhe ujitja	17
3.6 Resurset ujore.....	17
3.6.1 Rrjeti hidrografik.....	17
3.6.2 Sistemi i furnizimit me ujë	19
3.6.3 Sistemi i kanalizimit.....	20
3.7 Mjedisi.....	23
3.7.1 Ndotja e ajrit.....	23
3.7.2 Ndotja e tokës	24
3.7.3 Ndotja e ujit.....	24
3.7.4 Vërshimet.....	25
3.8 Problemet kryesore të identifikuar	26
3.9 Resurset Ujore dhe Infrastruktura Teknike	27
3.9.1 Sistemi i furnizimit me ujë	27
3.9.2 Sistemi i kanalizimit.....	30
3.9.3 Sistemi i ujitjes bujqësore.....	32
3.9.4 Drenazhimi dhe kullimi	34
4. ANALIZA SWOT	36

4.1 Matrica SWOT.....	36
4.2 Konkluzionet strategjike.....	37
5. OBJEKTIVAT DHE MASAT	37
5.1 Objektiva e përgjithshme	37
5.2 Objektivi specifik 1: Rritja e investimeve infrastrukturore për mbrojtjen e ujërave	37
5.3 Objektivi specifik 2: Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimi i impianteve të trajtimit	38
5.4 Objektivi specifik 3: Zvogëlimi i ndotjes industriale të ujërave	40
5.5 Objektivi specifik 4: Përmirësimi i infrastrukturës së lumenjve dhe parandalimi i vërshimeve	41
5.6 Objektivi specifik 5: Ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen e ujërave	42
5.7 Përmbledhja e objektivave dhe lidhja me fazat	43
6. INVESTIMET NË INFRASTRUKTURË DHE PRIORITIZIMI.....	43
6.1 Rëndësia e investimeve në infrastrukturë	43
6.2 Matrica e prioritizimit të investimeve	44
6.3 Lidhja e investimeve me objektivat strategjike	44
6.4 Fazat e zbatimit dhe afatet kohore.....	45
6.5 Zonat kryesore të investimeve.....	46
6.6 Investimet e planifikuara me buxhetin e Kosovës deri në vitin 2026	46
7. KOORDINIMI DHE QEVERISJA.....	47
7.1 Parimet e koordinimit.....	47
7.2 Struktura institucionale dhe organogrami.....	47
7.3 Rolet, vendimmarrja dhe raportimi sipas institucioneve	49
7.4 Grupi Punues Komunal për Ujërat.....	50
7.5 Mekanizmat e koordinimit vertikal dhe horizontal.....	50
7.6 Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit	51
7.6.1 Adresa e qartë për zbatimin, monitorimin dhe raportimin.....	52
7.7 Ngritja e kapaciteteve	52
8. PJESËMARRJA PUBLIKE DHE KOMUNIKIMI	53
8.1 Rëndësia e pjesëmarrjes publike.....	53
8.2 Mekanizmat e pjesëmarrjes publike.....	53
8.3 Fushatat e ndërgjegjësimit publik	53
8.4 Kanalet e komunikimit	54
8.5 Trajtimi i ankesave dhe kërkesave.....	55
9. PROJEKSIONET FINANCIARE DHE ZBUTJA E RREZIQEVE	55
9.1 Projektionet e detajuara financiare.....	55
9.1.1 Kostoja kapitale.....	55

9.1.2 Kostoja operative vjetore.....	55
9.1.3 Projeksionet financiare afatgjata (2026–2035)	56
9.2 Burimet e financimit.....	56
9.2.1 Korniza orientuese për PPP dhe kriteret minimale të aplikimit.....	57
9.3 Vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut financiar.....	57
9.3.1 Identifikimi i rreziqeve financiare	57
9.3.2 Strategjitë e zbutjes së rreziqeve	58
9.3.3 Skenari alternativ (kur mungojnë grantet).....	58
10. MENAXHIMI I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET	59
10.1 Konteksti dhe lidhja me sistemin e kanalizimit	59
10.2 Zonat e rrezikuara dhe masat e propozuara	59
10.3 Masat parandaluese	60
10.3.1 Masat strukturore	60
10.3.2 Masat jostrukturore	60
10.4 Sistemi i paralajmërimit të hershëm (propozim)	60
10.5 Plani për reduktimin e rrezikut nga përmbytjet.....	61
11. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PERFORMANCËS.....	63
11.1 Qëllimi i monitorimit.....	63
11.2 Treguesit kryesorë të performancës (TKP)	63
11.2.1 Burimet e të dhënave dhe metodologjia e matjes së TKP	64
11.3 Orari i rishikimeve.....	64
11.4 Metodologjia e monitorimit.....	65
11.4.1 Parimet e monitorimit	65
11.4.2 Burimet e të dhënave dhe përgjegjësitë	65
11.4.3 Procesi i analizës dhe raportimit.....	66
11.4.4 Publikimi dhe transparencia	66
11.4.5 Sigurimi i cilësisë së të dhënave.....	66
11.5 Menaxhimi adaptiv.....	67
12. REFERENCAT.....	69
ANEKSET	70
ANEKSI 1: LISTA E PLOTË E VENDBANIMEVE ME TË DHËNA PËR KANALIZIM DHE FURNIZIM ME UJË	70
ANEKSI 2: HARTAT TEKNIKE.....	71
ANEKSI 3: TERMAT E REFERENCËS PËR STUDIMET E FIZIBILITETIT	74
ANEKSI 4: FORMULARËT PËR RAPORTIM DHE MONITORIM.....	76
ANEKSI 5: LISTA E KONTAKTEVE TË INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE	79

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Fazat e zbatimit, ndërhyrjet kryesore dhe kostoja e parashikuar	8
Tabela 2. Metodologjia e hartimit të strategjisë.....	12
Tabela 3. Të dhënat kryesore gjeografike të Komunës së Rahovecit	13
Tabela 4. Karakteristikat klimatike të Komunës së Rahovecit	14
Tabela 5. Evolucion i popullsisë së Komunës së Rahovecit (1948–2022)	14
Tabela 6. Popullsia dhe ekonomitë familjare sipas vendbanimeve në komunën e Rahovecit, 2011 dhe 2024.....	15
Tabela 7. Mbulimi me sistem ujitjeje në Komunën e Rahovecit.....	17
Tabela 8. Lumenjtë dhe përroskat kryesore në Komunën e Rahovecit	18
Tabela 9. Burimet kryesore ujore dhe karakteristikat e tyre	18
Tabela 10. Mbulimi me ujësjellës në Komunën e Rahovecit	19
Tabela 11. Rezervuarët kryesorë – Komuna e Rahovecit (PAI 2019–2028).....	20
Tabela 12. Mbulimi me kanalizim në Komunën e Rahovecit	21
Tabela 13. Burimet kryesore të ndotjes së ajrit në Komunën e Rahovecit.....	23
Tabela 14. Vërshimet e regjistruara në Komunën e Rahovecit (2018–2021)	25
Tabela 15. Matrica e rreziqeve klimatike për Komunën e Rahovecit	26
Tabela 16. Problemet kryesore të identifikuar dhe pasojat e tyre	26
Tabela 17. Burimet kryesore të ujit dhe kapaciteti i tyre.....	27
Tabela 18. Karakteristikat e burimeve ujore lokale	27
Tabela 19. Gjysjellësit kryesorë të sistemit të furnizimit me ujë	28
Tabela 20. Stacionet e pompimit dhe gjendja aktuale.....	28
Tabela 21. Rezervuarët dhe kapaciteti i tyre	29
Tabela 22. Mbulimi me ujësjellës sipas vendbanimeve	29
Tabela 23. Përmbledhja e mbulimit me ujësjellës	30
Tabela 24. Mbulimi me kanalizim sipas vendbanimeve	31
Tabela 25. Përmbledhja e mbulimit me kanalizim.....	31
Tabela 26. Vendbanimet sipas sistemit të ujitjes.....	32
Tabela 27. Përmbledhja e mbulimit me ujitje.....	33
Tabela 28. Sipërfaqet e ujitura sipas vendbanimeve (2021).....	33
Tabela 29. Matrica SWOT për menaxhimin e ujërave të zeza në Komunën e Rahovecit	36
Tabela 30. Masat dhe treguesit për Objektivin Specifik 1	38
Tabela 31. Masat dhe treguesit për Objektivin Specifik 1	38
Tabela 32. Masat dhe treguesit për Objektivin Specifik 3	40
Tabela 33. Masat dhe treguesit për Objektivin Specifik 4	41
Tabela 34. Masat dhe treguesit për Objektivin Specifik 5	42
Tabela 35. Përmbledhja e objektivave, indikatorëve kryesorë dhe fazave	43
Tabela 36. Matrica e prioritizimit të investimeve sipas zonave	44
Tabela 37. Lidhja Objektiv – Investim – Kosto – Afat – Zonë	44
Tabela 38. Fazat e zbatimit të investimeve	45
Tabela 39. Zonat kryesore të investimeve dhe përshkrimi i tyre.....	46
Tabela 40. Institucionet, rolet, vendimmarrja dhe raportimi	49
Tabela 41. Struktura dhe funksionimi i Grupit Punues Komunal.....	50
Tabela 42. Mekanizmat e koordinimit vertikal (me nivelin qendror)	50
Tabela 43. Mekanizmat e koordinimit horizontal (me komunat fqinje dhe aktorët lokalë).....	51
Tabela 44. Struktura e raportimit për zbatimin e strategjisë.....	51

Tabela 45. Indikatorët e koordinimit dhe qeverisjes	52
Tabela 46. Mekanizmat e pjesëmarrjes publike dhe menaxhimi i tyre	53
Tabela 47. Plan i fushatave ndërgjegjëse 2026–2031	54
Tabela 48. Kostoja kapitale sipas komponentëve	55
Tabela 49. Kostoja operative vjetore e parashikuar (pas 2030)	55
Tabela 50. Projeksionet financiare 10-vjeçare	56
Tabela 51. Përmbledhje e investimeve të planifikuara (PAI 2019–2028)	56
Tabela 52. Burimet e financimit dhe kontributi i parashikuar	57
Tabela 53. Rreziqet financiare, probabiliteti dhe ndikimi	57
Tabela 54. Strategjitë e zbutjes së rreziqeve financiare	58
Tabela 55. Zonat e rrezikuara, masat, prioriteti dhe kostoja	59
Tabela 56. Masat strukturore parandaluese	60
Tabela 57. Masat jostrukturore parandaluese	60
Tabela 58. Komponentët e sistemit të paralajmërimit të hershëm	61
Tabela 59. Plan i veprimit për reduktimin e rrezikut nga përmbytjet	61
Tabela 60. Treguesit kryesorë të performancës	63
Tabela 61. Orari i rishikimeve strategjike	64
Tabela 62. 11.4 Metodologjia e monitorimit	65
Tabela 63. Procesi i analizës dhe raportimit	66
Tabela 64. Lista e vendbanimeve (Komuna e Rahovecit): Kanalizim + Furnizim me ujë	70

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Pozita gjeografike e Komunës së Rahovecit	13
Figura 2. Regjistrimi i popullsisë në Kosovë 2024	15
Figura 3. Shpërndarja e popullsisë urbane/rurale në Komunën e Rahovecit	16
Figura 4. Harta e rrjetit të ujësjellësit – Furnizimi me ujë të pijshëm	34
Figura 5. Harta e rrjetit të kanalizimit – Qasja në rrjetin e kanalizimit	35
Figura 6. Grafiku i afateve kohore të investimeve sipas fazave	46
Figura 7. Organogrami i koordinimit institucional për zbatimin e strategjisë	48
Figura 8. Harta e zonave me rrezik të lartë nga përmbytjet në Komunën e Rahovecit	62
Figura 9. Cikli i menaxhimit adaptiv	68

LISTA E FOTOGRAFIVE

Foto 1. Rrjedha e Drinit të Bardhë	19
Foto 2. Ndotja e ajrit nga djegia e lëndëve fosile për ngrohje, Rahovec	23
Foto 3. Vërshime në Rahovec	26

LISTA E SHKURTESAVE

Shkurtesa	Emërtimi i plotë
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ARPL	Autoriteti i Pellgut Lumor (i Drinit)
ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BE (njësi)	Banorë Ekuivalent (njësi matëse për kapacitetin e impianteve)
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BOD/ BOD5	Biochemical Oxygen Demand / Kërkesa Biokimike për Oksigjen (5 ditë)
COD	Chemical Oxygen Demand / Kërkesa Kimike për Oksigjen
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
€	Euro (monedha)
ha	Hektar
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
IPA	Instrument for Pre-Accession Assistance / Instrumenti i Para-Anëtarësimit
KAB	Korniza Afatmesme Buxhetore
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau (Banka Gjermane për Zhvillim)
km	Kilometër
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
l/sek	Litra për sekondë
m	Metër
m ²	Metër katror
m ³	Metër kub
mg/L	Miligram për litër
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
NJPZ	Njësia për Mbrojtje dhe Shpëtim
OJQ	Organizata Joqeveritare
OS	Objektivi Specifik
PLVM	Plani Lokal për Veprim në Mjedis
PM / PM ₁₀	Particulate Matter / Grimecat e pezulluara (me diametër ≤10 µm)
PPP	Partneritet Publiko-Privat
Q1, Q2, Q3, Q4	Tremujori i parë, dytë, tretë, katërt (i vitit)
RKS	Republika e Kosovës
SECAP	Sustainable Energy and Climate Action Plan / Plani i Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë
SMART	Specific, Measurable, Achievable, Relevant, Time-bound (kriteret për objektiva)
SO ₂	Dioksid sulfuri
NO _x	Oksidet e azotit
CO ₂	Dioksid karboni
SWOT	Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats (Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë, Kërcënimet)
TBD	To Be Determined / Për t'u përcaktuar
TKP	Treguesit Kryesorë të Performancës
TSS	Total Suspended Solids / Lëndët e ngurta të pezulluara
UA	Udhëzim Administrativ
UNEP	United Nations Environment Programme / Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin
WWTP	Waste Water Treatment Plant / Impiant i Trajtimit të Ujërave të Zeza

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1.1 Konteksti dhe problemi kryesor

Komuna e Rahovecit, me një popullsi prej rreth 41,799 banorësh dhe sipërfaqe prej 276 km², disponon një rrjet kanalizimi që mbulon 95.69% të popullsisë, por pothuajse të gjitha ujërat e zeza shkarkohen pa asnjë trajtim paraprak në Lumin Drini i Bardhë dhe degëzimet e tij. Aktualisht, i vetmi implant funksional është sistemi lagun në fshatin Kramovik, i cili shërben vetëm për një vendbanim të vogël. Shkarkimi i vazhdueshëm i ujërave të patrajtuar përbën rrezik serioz për shëndetin publik, ndot burimet ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore, degradon ekosistemet ujore dhe pengon zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të komunës. Sipas vlerësimeve, çdo vit shkarkohen në trupa ujorë mbi 925,000 m³ ujëra të zeza pa trajtim, duke krijuar një ngarkesë ndotëse që tejkalon kapacitetin vetëpastrues të lumenjve dhe rrezikon cilësinë e ujit edhe për komunat e poshtme të pellgut të Drinit.

1.2 Objektivi strategjik

Kjo strategji synon vendosjen e një sistemi funksional, të qëndrueshëm dhe financiarisht të realizueshëm për trajtimin e ujërave të zeza në Komunën e Rahovecit deri në vitin 2031.

1.3 Ndërhyrjet kryesore

Për të arritur objektivin strategjik, parashihen këto ndërhyrje kryesore:

- **Ndërtimi i katër impianteve të trajtimit (WWTP):** Një implant kryesor urban për qytetin e Rahovecit dhe tri impiante rurale për zonat e Krushës së Madhe dhe Gexhës, dhe Retisë me kapacitet të përshtatshëm për popullsinë dhe perspektivën e zhvillimit.
- **Ndërtimi i kolektorëve kryesorë:** Kolektorë gravitetikë dhe me pompim për grumbullimin dhe transportin e ujërave fekale nga zonat urbane dhe rurale deri te implantet e trajtimit.
- **Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit:** Riparimi i segmenteve të vjetruara, zëvendësimi i gypave të dëmtuar dhe zgjerimi i rrjetit në zonat e pambuluara.
- **Ndarja progresive e sistemit fekal nga ai atmosferik:** Ndërhyrje për eliminimin e përzierjes së ujërave fekale me ato atmosferike, duke reduktuar ngarkesën hidraulike në implantet e trajtimit dhe rrezikun nga përmblytjet urbane.
- **Masat kundër përmblytjeve:** Ndërtimi i kanaleve atmosferike, mureve mbrojtëse dhe sistemeve të kullimit në zonat e rrezikuara, të integruara me sistemin e kanalizimit.

1.4 Kostoja dhe fazat e zbatimit

Zbatimi i strategjisë është planifikuar në tre faza kryesore, me një kosto totale të parashikuar prej 17,500,000 €. Kostoja përfshin investimet kapitale për infrastrukturë, studimet teknike, mbikëqyrjen dhe një kontingjencë për rreziqe të papritura.

Tabela 1. Fazat e zbatimit, ndërhyrjet kryesore dhe kostoja e parashikuar

Faza	Periudha	Ndërhyrjet kryesore	Kosto (€)
------	----------	---------------------	-----------

I	2025–2027	WWTP kryesor urban (Rahovec), kolektorët kryesorë urbanë, rehabilitimi urgjent i rrjetit ekzistues	8,500,000
II	2028–2029	Tri WWTP rurale (Krushë e Madhe, Gexhë, Reti), kolektorët ruralë, zgjerimi i rrjetit periferik	5,500,000
III	2030–2031	Ndarja progresive fekale/atmosferike, kanale atmosferike dhe kulluese, mure mbrojtëse kundër përmytjeve, modernizimi i impianteve	3,500,000
Totali	2025–2031		17,500,000

Burimet e financimit të parashikuara si parashikim indikativ janë:

- Grante ndërkombëtare (BE, KfW, BERZH): 40% (~7,000,000 €)
- Partneritete publiko-private (PPP): 30% (~5,250,000 €)
- Kontribute lokale dhe tarifa: 20% (~3,500,000 €)
- Buxheti qendror dhe lokal: 10% (~1,750,000 €)

1.5 Institucionet përgjegjëse

Zbatimi i strategjisë do të koordinohet nga një strukturë institucionale e qartë, me përgjegjësi të ndara sipas rolit:

Institucioni	Roli kryesor
Komuna e Rahovecit	Planifikimi strategjik, koordinimi lokal, bashkëfinancimi, mbikëqyrja e zbatimit, raportimi te niveli qendror
KRU "Gjakova"	Operimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të kanalizimit dhe impianteve të trajtimit, mbledhja e tarifave, raportimi teknik
MMPHI (Ministria e Mjedisit, Planifikimit dhe Hapësinor dhe Infrastrukturës)	Politikat sektoriale, harmonizimi me direktivat e BE-së, mbështetja financiare nga buxheti qendror, mbikëqyrja e përputhshmërisë
AMMK (Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës)	Monitorimi mjedisor, inspektimi, lëshimi i lejeve mjedisore, raportimi i cilësisë së ujërave
Donatorët ndërkombëtarë	Financimi i projekteve kapitale, asistenca teknike, mbikëqyrja e projekteve të financuara

2. HYRJA

2.1 Lidhja me dokumentet strategjike dhe korniza ligjore

Kjo strategji është hartuar në përputhje me kornizën ligjore dhe dokumentet strategjike të Republikës së Kosovës, si dhe me direktivat relevante të Bashkimit Evropian. Harmonizimi me këto dokumente siguron koherencë të politikave dhe mundëson aksesin në financime nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare.

Korniza ligjore kombëtare:

- Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës (veçanërisht neni 47: Programi për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave)
- Udhëzimi Administrativ Nr. 19/2015 për Veprimet e Dëmshme të Ujërave
- Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturinat dhe plotesim ndryshimi I ligjit nr.08/L-071.
- Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit

Dokumentet strategjike kombëtare:

- Strategjia Shtetërore për Ujërat e Kosovës 2022–2026 (dhe rishikimi 2023–2027)
- Plani Hapësinor i Kosovës
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim

Dokumentet strategjike lokale:

- Plani Zhvillimor Komunal i Rahovecit 2023–2031
- Plani Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM) 2021–2026
- Plani i Menaxhimit të Mbeturinave për Komunën e Rahovecit 2021–2027
- Plani i Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë (SECAP) i Komunës së Rahovecit
- **Plani Afatgjatë i Investimeve (PAI) 2019–2028 i KRU “Gjakova” Sh.A.** (është dokumenti kryesor planifikues i operatorit rajonal për investime në ujësjellës dhe kanalizim në zonën e shërbimit (përfshirë Komunën e Rahovecit). PAI përcakton objektivat e performancës (nivel shërbimi, humbjet e ujit, arkëtimin, mbulueshmërinë e kanalizimit), si dhe dinamikën dhe burimet e financimit për investime kapitale në periudhën 10-vjeçare. Ky dokument përdoret si bazë për harmonizimin e prioriteteve dhe për koordinimin Komunë–KRU në planifikim, projektim dhe zbatim të investimeve).
- **Plani i Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë** (Strategjia për Menaxhimin e Ujërave të Zeza harmonizohet me SECAP të Komunës së Rahovecit, veçanërisht në komponentën e **adaptimit ndaj rreziqeve klimatike** (përmbytjet lokale, thatësirat dhe ulja e burimeve ujore) dhe në komponentën e **qeverisjes/monitorimit**. Në përputhje me qasjen e SECAP, strategjia e ujërave të zeza bazohet në **indikatore të qartë të performancës (TKP/KPI)** dhe në **raportim të rregullt** për të siguruar transparencë, llogaridhënie dhe përmirësim të vazhdueshëm gjatë zbatimit).

Direktivat e Bashkimit Evropian:

- Direktiva 91/271/EEC për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane
- Direktiva 2000/60/EC (Direktiva Kornizë për Ujërat)
- Direktiva 2007/60/EC për Vlerësimin dhe Menaxhimin e Rreziqeve nga Përmytjet

2.2 Qëllimi dhe dimensionet e strategjisë

Strategjia për Menaxhimin e Ujërave të Zeza në Komunën e Rahovecit (2026–2031) adreson katër dimensionet e ndërlidhura, të cilat së bashku sigurojnë një qasje të integruar ndaj problemit:

1. **Mbrojtja e ujërave:** Parandalimi i ndotjes së trupave ujorë sipërfaqësorë (Drini i Bardhë dhe degëzimet) dhe ujërave nëntokësore, përmes trajtimit të ujërave të zeza para shkarkimit.
2. **Investimet në infrastrukturë:** Ndërtimi i impianteve të trajtimit, kolektorëve dhe rehabilitimi i rrjetit ekzistues, duke siguruar mbulim progresiv të popullsisë me shërbime adekuate.
3. **Përdorimi efikas i burimeve:** Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve ujore dhe reduktimi i humbjeve në sistem, duke kontribuar edhe në mbrojtjen e burimeve të ujit të pijshëm.
4. **Vetëdijësimi publik:** Edukimi i komunitetit për mbrojtjen e ujërave, përdorimin e duhur të sistemit të kanalizimit dhe raportimin e problemeve.

2.3 Fokuset operationale të strategjisë

Strategjia do të shërbejë si udhërrëfyes për autoritetet lokale në katër fokuse operationale:

- **Kohezioni i politikave:** Harmonizimi i politikave sektoriale komunale (infrastrukturë, mjedis, zhvillim urban, bujqësi) në funksion të mbrojtjes nga veprimet e dëmshme të ujërave të zeza.
- **Koordinimi institucional:** Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Rahovecit, KRU "Gjakova", nivelit qendror (MMPHI, AMMK) dhe mekanizmave të pellgut lumor.
- **Integrimi financiar:** Bashkërendimi i financimeve nga burime të ndryshme (buxheti lokal dhe qendror, grantet ndërkombëtare, PPP, tarifat) për të siguruar qëndrueshmëri financiare.
- **Përfshirja komunitare:** Angazhimi i komuniteteve dhe akterëve lokalë në identifikimin e nevojave, zbatimin e masave dhe monitorimin e rezultateve.

2.4 Metodologjia

Hartimi i kësaj strategjie është bazuar në pesë qasje metodologjike, të cilat sigurojnë një bazë solide të dhënash dhe analizash:

Tabela 2. Metodologjia e hartimit të strategjisë

Nr.	Metoda	Përshkrimi
1	Analizë dokumentesh	Shqyrtimi sistematik i dokumenteve strategjike kombëtare dhe lokale, legjisllacionit në fuqi, raporteve teknike dhe studimeve ekzistuese për sektorin e ujërave
2	Të dhëna statistikore	Grumbullimi dhe analiza e të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), KRU "Gjakova", AMMK dhe institucione të tjera relevante
3	Vizita terreni	Vëzhgime në terren për vlerësimin e gjendjes fizike të infrastrukturës ekzistuese, identifikimin e pikave kritike të shkarkimit dhe zonave të rrezikuara
4	Konsultime institucionale	Takime pune me Komunën e Rahovecit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Urbanizmit, KRU "Gjakova" dhe drejtoritë relevante për validimin e të dhënave dhe prioritetëve
5	Analizë krahasuese	Krahasimi i gjendjes aktuale me praktikën më të mira në Kosovë, rajon dhe standardet e BE-së, për të identifikuar zgjidhje të përshtatshme

2.5 Vizioni

"Të krijojmë një komunitet të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm përmes një menaxhimi efektiv të ujërave të zeza, që mbron mjedisin, përmirëson cilësinë e jetës dhe kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës së Rahovecit."

2.6 Misioni

"Të sigurojmë një sistem të qëndrueshëm dhe efikas të menaxhimit të ujërave të zeza që garanton mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik. Përmes trajtimit cilësor të ujërave, përmirësimit të infrastrukturës dhe angazhimit të komunitetit, synojmë të minimizojmë ndikimet negative dhe të kontribuojmë në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës."

3. ANALIZA E GJENDJES

3.1 Të dhënat e përgjithshme dhe pozita gjeografike

Komuna e Rahovecit ndodhet në pjesën jugperëndimore të Republikës së Kosovës dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 276 km². Ajo kufizohet me komunat Gjakovë (perëndim), Klinë (Veri), Prizren (jug), Malishevë (veri-lindje) dhe Suharekë/Mamushë (jug-lindje), duke pasur një pozitë lidhëse të rëndësishme për qarkullimin ekonomik dhe shërbimet publike. Koordinatat gjeografike të qendrës së komunës janë: Gjerësia gjeografike 42°23' N dhe Gjatësia gjeografike 20°39' E.

Distanca orientuese nga qendrat kryesore janë: Prishtinë ~70 km, Gjakovë ~25 km, Prizren ~30 km, Malishevë ~18 km. Shtrirja altitudinale e territorit është 310–920 m mbi nivelin e detit, çka ndikon në rrjedhjet sipërfaqësore, rrezikun nga përmbytjet lokale dhe kushtet e projektimit të rrjetit të kanalizimit (gravitet/pompim).

Tabela 3. Të dhënat kryesore gjeografike të Komunës së Rahovecit

Parametri	Vlera
Sipërfaqja totale	276 km ²
Lartësia mbidetare	310–920 m
Kufizohet me	Gjakovë, Prizren, Malishevë, Suharekë, Mamushë, Klinë
Distanca nga Prishtina	~70 km
Klimë	Kontinentale me ndikim mesdhetar
Sektori kryesor ekonomik	Bujqësi dhe agroindustri (veçanërisht vreshtari)

Kategorizimi i vendbanimeve sipas lartësisë mbidetare:

Kategoria	Lartësia (m)	Vendbanimet përfaqësuese
Luginore-rrafshore	310–350	Xërxë, Bellacërkë, Gexhë, Radostë, Ratkoc, Çifllak, Dejnë, Hoçë e Vogël, Retijë
Kodrinore	350–600	Rahovec, Drenoc, Krushë e Madhe, Optrushë, Pastaselë, Celinë, Kramovik
Malore	600–1000	Zatriq, Kaznik, Drenoc (pjesë)

Ky profil altitudinal ka implikime të drejtpërdrejta për projektimin e sistemit të kanalizimit: zonat e ulëta kërkojnë kolektorë gravitetikë dhe mundësisht stacione pompimi, ndërsa zonat kodrinore dhe malore mund të shfrytëzojnë gravitetin për transport të ujërave drejt pikave të trajtimit.

**Figura 1. Pozita gjeografike e Komunës së Rahovecit**

3.2 Klima

Në territorin e Komunës së Rahovecit mbizotëron klimë kontinentale me ndikim mesdhetar, e cila karakterizohet nga variacione të theksuara sezonale. Këta parametra klimatikë janë të rëndësishëm për dimensionimin e rrjeteve të kanalizimit (prurjet në reshje intensive), për menaxhimin e infiltrimit dhe rrjedhjeve të përziera, si dhe për vlerësimin e kushteve operative të impianteve të trajtimit.

Tabela 4. Karakteristikat klimatike të Komunës së Rahovecit

Parametri	Vlera
Tipi i klimës	Kontinentale me ndikim mesdhetar
Reshjet mesatare vjetore	765 mm
Temperatura mesatare vjetore	11.8°C
Muaji më i nxehtë	Korrik
Temperatura maksimale e regjistruar	38.5°C
Muaji më i ftohtë	Shkurt
Temperatura minimale e regjistruar	-14.5°C
Reshjet mesatare në sezonin e vegjetacionit	56.17 mm/m ²

Erërat dominuese:

- Veri-lindje: 62%
- Perëndim: 50%
- Veri: 11.8%
- Erërat më pak të zakonshme: Lindje (17%), Jug (14%), Jug-lindje (4%)

Reshjet intensive, veçanërisht në periudhën pranverore (prill–maj) dhe vjeshtore (shtator–tetor), krijojnë ngarkesa të larta hidraulike në sistemin e kanalizimit dhe rrisin rrezikun nga përmytjet në zonat e ulëta. Kjo kërkon që sistemi i kanalizimit të projektohet me kapacitet të mjaftueshëm dhe që të bëhet ndarja progresive e ujërave fekale nga ato atmosferike.

3.3 Demografia

Bazuar në regjistrimin e vitit 2011, Komuna e Rahovecit kishte 56,208 banorë rezident, ndërsa sipas Vjetarit të Vlerësimit të Popullsisë 2022 të ASK-së, vlerësohen 41,799 banorë rezident. Popullsia është e shpërndarë kryesisht në zonat rurale: 13,642 banorë në zonën urbane (32.63%) dhe 28,157 banorë (67.36%) në zonat rurale.

Tabela 5. Evolucion i popullsisë së Komunës së Rahovecit (1948–2022)

Viti	Numri i popullsisë	Burimi
1948	20,350	Regjistrimi
1953	22,687	Regjistrimi
1961	26,839	Regjistrimi
1971	35,215	Regjistrimi
1981	46,459	Regjistrimi
1991	59,877	Vlerësim i Komunës
2011	56,208	Regjistrimi

STRATEGJIA PËR MENAXHIMIN E UJËRAVE TË ZEZA NË KOMUNËN E RAHOVECIT 2025 – 2031

2022	55,391	Vlerësim ASK
2024	41,799	Regjistrimi I popullsise ASK

Ky profil demografik kërkon qasje të kombinuar për menaxhimin e ujërave të zeza: zgjidhje të centralizuara për zonën urbane (qyteti i Rahovecit) dhe zgjidhje të përshtatura me faza/nën-zona për vendbanimet rurale, në mënyrë që të sigurohet mbulim progresiv i trajtimit deri në vitin 2030.




Figura 2. Regjistrimi i popullësisë në Kosovë 2024

Tabela 6. Popullsia dhe ekonomitë familjare sipas vendbanimeve në komunën e Rahovecit, 2011 dhe 2024

	2011		2024	
	Popullsia	Ekonomitë Familjare	Popullsia	Ekonomitë Familjare
TOTALI	56208	8221	41799	9180
Bellacrkë	2270	318	1582	347
Bërnjak	40	5	32	10
Bratotin	396	52	265	61
Brestovc	1288	187	704	156
Celinë	1903	245	1271	277
Çifllak	1292	164	1130	237
Dabidoi	799	91	418	76
Dejnë	1757	205	1225	267
Drenoc	1587	212	880	205
Gexhë	660	88	503	117
Hoçë e Madhe	124	27	508	159
Hoçë e Vogël	1166	168	987	214
Kaznik	164	22	105	21
Kramovik	1125	130	780	162

STRATEGJIA PËR MENAXHIMIN E UJËRAVE TË ZEZA NË KOMUNËN E RAHOVECIT 2025 – 2031

Krushë e Madhe	4473	629	3183	677
Mrasor	191	28	158	31
Nagavc	743	110	623	125
Nushpal	220	37	186	38
Opterushë	1911	249	1091	262
Pastasellë	1011	127	757	156
Pataçan i Epërm	533	78	244	58
Pataçan i Ulët	1077	139	672	154
Petkoviq	731	85	746	151
Polluzhë	808	91	517	116
Radostë	2346	300	1507	338
Rahovec	15892	2840	13642	3013
Ratkoc	3791	526	2713	608
Reti e Ulët	234	36	170	31
Retijë	771	107	492	115
Sapniq	996	134	525	130
Sarosh	6	1	0	0
Senoc	687	90	585	112
Vrajakë	838	97	625	119
Xërxë	3184	439	2378	490
Zatriq	535	55	196	37
Zoçishtë	659	109	399	110

Dendësia mesatare e popullsisë në komunë është ~152 banorë/km². Mesatarisht, një familje zë një banesë dhe sipërfaqja mesatare e shfrytëzuar është 12 m²/banor.




Figura 3. Shpërndarja e popullsisë urbane/rurale në Komunën e Rahovecit

3.4 Ekonomia

Komuna e Rahovecit përballet me sfida të konsiderueshme ekonomike, të cilat ndikojnë edhe në kapacitetin për investime dhe mirëmbajtje të infrastrukturës së ujërave të zeza.

Treguesit kryesorë ekonomikë:

- Shkalla e papunësisë në Kosovë: ~25.7%
- Popullsia në moshë pune (15–64 vjeç): 59.5% e totalit
- Punësimi i femrave: ~11% e totalit të të punësuarve në komunë
- Familje me asistencë sociale: 590 familje (2,581 persona)

Sektorët kryesorë ekonomikë të komunës janë bujqësia, veçanërisht vreshtaria dhe prodhimi i verës, si dhe tregtia dhe shërbimet. Rahoveci është qendra kryesore e vreshtarisë në Kosovë, duke disponuar rreth 50% të sipërfaqeve të vreshtave të vendit, me një sipërfaqe totale prej 2,168 hektarësh.

3.5 Bujqësia dhe ujitja

Bujqësia është degë e rëndësishme e ekonomisë lokale, me kushte të favorshme natyrore për vreshtari, primekulturë dhe drithëra. Aktiviteti bujqësor mbështetet edhe nga sistemi i ujitjes i menaxhuar nga Kompania Rajonale e Ujitjes (KRU) "Radoniqi-Dukagjini", i cili siguron ujitje për 2,658 hektarë tokë bujqësore.

Sistemet e ujitjes në përdorim:

- Sistemi i ujitjes me rrjedhje të lirë
- Sistemi i ujitjes në formë shiu
- Sistemi i ujitjes së lokalizuar (pikatore)

Tabela 7. Mbulimi me sistem ujitjeje në Komunën e Rahovecit

Kategoria	Numri i banorëve të zonave	Përqindja
Me sistem ujitjeje (KRU "Radoniqi-Dukagjini")	17,512	41%
Pa sistem ujitjeje	23,664	59%
Totali	41,799	100%?

Ky profil bujqësor e rrit ndjeshmërinë ndaj ndotjes së trupave ujorë dhe kërkon që strategjia e ujërave të zeza të ketë masa të qarta për parandalimin e shkarkimeve të patrajtuara dhe mbrojtjen e burimeve ujore, veçanërisht gjatë reshjeve intensive dhe përmbytjeve lokale.

3.6 Resurset ujore

3.6.1 Rrjeti hidrografik

Territori i Komunës së Rahovecit lidhet drejtpërdrejt me sistemin hidrografik të Drinit të Bardhë, i cili rrjedh nëpër komunë me gjatësi rreth 30 km. Ky lum përshkon territorin e komunës dhe shërben edhe si kufi administrativ me komunat Prizren, Gjakovë, Malishevë dhe Klinë.

Në Drinin e Bardhë derdhen edhe lumenj dhe përroska lokale si Drinas, Rimnik, Polluzhë, Hoçë, Duhillo, Sopniq dhe Bellaja. Kjo hidrografi e bën kritike parandalimin e shkarkimeve të patrajtuara të ujërave të zeza dhe reduktimin e ndotjes difuze, sepse ndikimet shfaqen shpejt në trupat ujorë sipërfaqësorë dhe në përdorimet e ujit për bujqësi dhe ekosisteme.

Karakteristikat e Drinit të Bardhë në territorin e Rahovecit:

- Gjatësia në komunë: ~30 km
- Gjerësia mesatare e shtratit: 50–100 m
- Thellësia e shtratit: 1–5 m

Tabela 8. Lumenjtë dhe përroskat kryesore në Komunën e Rahovecit

Emri i lumit	Burimi	Karakteristikat kryesore
Lumi i Hoçës	Hoçë e Madhe (420 m lartësi)	Bashkohet me përroskën e Babindollit, derdhet në Drinin e Bardhë
Lumi Bellaja	Bellacërkë	Degë e majtë e Drinit, gjatësia ~3 km
Lumi Duhillo	Rahovec (3 burime: Duhillo, Vrella, Sopot)	Bashkohet me Rimnikun në km 4
Lumi Rimnik	Rrëzë malit Gërgavicë	Rëndësi ekonomike, bashkohet me Duhillo dhe Sopniq
Lumi Sopniq	Rrëzë malit të Drenocit	Shtrë gjatë verës (lum sezonal)

Tabela 9. Burimet kryesore ujore dhe karakteristikat e tyre

Burimet e ujit	Kapaciteti i prodhimit	Kapaciteti i shfrytëzuar (prodhimi)	
	(m ³ /vit)	(m ³ /vit)	(m ³ /ditë)
Pus në Drenoc	90,000	21,600	59,178
Pusi në Senoc	70,000	30,000	82,191
Burimi në Hoçë të Madhe	75,000	21,600	59,178
Burimi në Opterush	90,000	27,600	75,616
Prodhimi Total	325,000	100,800	276,163
Rrjeti hidrografik i disa burimeve ujore me karakteristika fizike të tyre			
Emërtimi	Lartësia mbidetare	Lit./sek.	Temp.
Burimi i Rahovecit	390	5 – 8	13
Burimi i Zatriqit	920	5	13
Burimi i Opterushës	400	40	13
Burimi i Zaqishtit	415	15	13
Burimi i Hoçë e Madhe	420	10	14
Burimi i Sopotit	380	6	13



Foto 1. Rrjedha e Drinit të Bardhë

3.6.2 Sistemi i furnizimit me ujë

Furnizimi me ujë të pijshëm për qytetarët e Komunës së Rahovecit sigurohet kryesisht nga Liqeni i Radoniqit, i cili ka kapacitet 117 milion m³ dhe menaxhohet nga KRU "Gjakova". Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të sistemit për furnizim me ujë të pijshëm në zonën e shërbimit të KRU "Gjakova" është 1,124.80 km.

Format e furnizimit me ujë:

1. Sistemi qendror publik (KRU "Gjakova")
2. Sistemet lokale të pompimit (për disa fshatra)
3. Puset individuale (për zonat e pambuluara)

Tabela 10. Mbulimi me ujësjellës në Komunën e Rahovecit

Kategoria	Numri i banorëve	Përqindja
Me ujësjellës publik (KRU "Gjakova")	37,578	89,9%
Pa ujësjellës publik	2,534	6,06%
Sisteme pompimi lokale	1,687	4%
Totali	41,799	100%

Problematika kryesore në furnizimin me ujë:

- Humbjet e ujit në sistemin shpërndarës: ~57%
- Kycje ilegale dhe mosmatje e saktë e konsumit
- Vështirësi në furnizim gjatë muajve të verës, sidomos në pikat e larta dhe të largëta të rrjetit

- Keqpërdorimi i ujit të pijshëm për ujitje të tokave gjatë periudhës së nxehtë

Komuna e Rahovecit furnizohet kryesisht nga Liqeni i Radoniqit (117 milion m³), ndërsa disa fshatra (p.sh. Hoçë e Madhe, Senoc, Drenoc, Opterush, Zaqisht) furnizohen edhe nga burime nëntokësore; dezinfektimi kryhet me klor të gaztë (para- dhe pas-klorinim).

Rezervuarët

Tabela 11. Rezervuarët kryesorë – Komuna e Rahovecit (PAI 2019–2028)

Rezervoari	Vendndodhja	Kapaciteti (m ³)
Rahovec I	Rahovec	1,500
Rahovec II	Rahovec	2,500
Pataqan I	Pataqan	180
Pataqan II	Pataqan	120
Pataqan (tjetër)	Pataqan	105
Vrajakë	Vrajakë	70
Bratotin	Bratotin	50
Rahovec III	Rahovec	250
Rahovec IV	Rahovec	600
Opterushë	Opterushë	315
Drenoc	Drenoc	300
Polluzhë	Polluzhë	400
Senoc	Senoc	300
Hoçë e Madhe	Hoçë e Madhe	200

Stacioni SP “Rahovec II” është me gjendje “Jo e mirë” (instaluar 1985), pra është kandidat i drejtpërdrejtë për rehabilitim/modernizim.

Masa : Rehabilitimi/modernizimi i stacionit të pompimit SP “Rahovec II” (zëvendësim pompash, pajisje elektro-mekanike, automatizim/SCADA, siguri energjetike), me qëllim rritjen e besueshmërisë së furnizimit dhe uljen e ndërprerjeve.

3.6.3 Sistemi i kanalizimit

Shumica e vendbanimeve të Komunës së Rahovecit kanë qasje në rrjet kanalizimi, por **mungon trajtimi i ujërave të zeza**. Të gjitha shkarkimet bëhen direkt në lumenj ose përroska pa trajtim paraprak, përveç fshatit Kramovik ku funksionon një impiant i tipit lagun.

Tabela 12. Mbulimi me kanalizim në Komunën e Rahovecit

Kategoria	Numri i banorëve	Përqindja
Me kanalizim	40,112	95.96%
Me kanalizim pjesërisht	1,582	3.78%
Pa kanalizim	105	0.25%
Totali	41,799	100%

Implantet ekzistuese të trajtimit:

Implanti Lagun në Kramovik: I vetmi implant funksional në komunë; shërben vetëm fshatin Kramovik. Të gjitha kanalizimet ekzistuese pikë shkarkimin e tyre e kanë në lumenj ose në përroska, pa asnjë trajtim paraprak, përveç fshatit Kramovik në të cilën është ndërtuar implanti, i cili trajton ujërat e zeza dhe më pas shkarkohen në Lumin Drini i Bardhë.

Në territorin e Komunës së Rahovecit është në funksion Implanti i sistemit Lagun në fshatin Kramovik. Për shkak të konfiguracionit të terrenit nuk mund të përfshihen të gjitha vendbanimet me një kolektor dhe të trajtohen në një implant por duhet të parashihen 3 kolektorë dhe 3 impiante për trajtimin e ujërave fekale, që shkarkohen në lumin Drini i Bardhë dhe lumenjtë tjerë. Ndërtimi i kolektorëve do të ndikojë pozitivisht në krijimin e një ambienti më të pastër dhe njëkohësisht plotësohet edhe kushti evropian për largim të ujërave të ndotur në lumenj. Kolektori kryesor që parashikohet të ndërtohet është në Krushë të Madhe, ndërsa kolektor tjer llogaritet të ndërtohen në Gexhe, Rahovec, Reti. Rrjeti i kanalizimeve duhet në vazhdimësi të rregullohet në vendet ku sistemi është vjetërsuara si dhe duhet të shqyrtohen nevojat për zgjerim të kanalizimit edhe në vendbanime në parcela të reja.

Në kuadër të investimeve nga Bashkimi Europian në programin e IPA-s për vitin 2024-2025 është bërë ndërtimi i sendimentuesve (Gropave Septike) për trajtimin e ujërave të zeza në 6 vendbanime të komunës së Rahovecit si: Palluzhë, Pastasel, Reti, Pataqan i Ulët, pataqan i Epërm dhe Rahovec.

Gjendja e rrjetit ekzistues:

Gjendja e kanalizimeve ekzistuese është e dobët dhe besohet se ndodhin rrjedhje të mëdha. Njohuria e sistemit të kanalizimeve është e kufizuar për shkak të mungesës së dokumentacionit teknik dhe daljes nga puna të operatorëve me njohuri historike të sistemit. Sistemi i kolektorëve lokal, sekondarë dhe kyçjeve të konsumatorëve nuk është planifikuar të rehabilitohet në asnjë prej nismave aktuale.

Investime e planifikuara në zgjerimin e rrjetit të kanalizimit për qytetin e Rahovecit (zonën urbane) janë vlerësuar me Studimin e Fizibilitetit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura të Rahovecit.

Mbikëqyrja e ndërtimit përfshin dy kontrata të punëve si vijojnë:

Në fund të vitit 2018, është ndërtuar një Impiant i vogël në fshatin Kramovik, nga donatorët. I cili është marrë në menaxhim në vitin 2019.

Investimet në rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit

Për rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit në komunën e Rahovecit është planifikuar që të zëvendësohet rrjeti i amortizuar dhe me dimensione joadekuatë, në gjatësi të përgjithshme në vlerë 12,817,045 €. Gjithashtu janë paraparë të ekzekutohen vazhdim i rrjetave ekzistuese ku do të paraqitet nevoja (shiko tab. nr.23).

Investimet në trajtimin e ujërave të ndotura

Gjatë vitit 2018-2020, do të ndërtohet një impiant i ri biologjik për trajtimin e ujërave të ndotura (ITUN). Tënderi është aktualisht në proces. ITUN synohet që të ndërtohet në dy Faza, Faza A (ky Projekt me një horizont të dizajnit deri në vitin 2025) dhe Faza B (zgjerimi në të ardhmen me një horizont të dizajnit deri në vitin 2040). Do të zbatohen kërkesat e mëposhtme të efluentit:

Si pjesë e Projektit "Eliminimi i Ujërave të Ndotura në Jugpërqendër të Kosovës Faza III, Gjakova" ("Projekti"), financuar nga Bashkëpunimi Financiar Gjerman dhe Zvicëran me Kosovën¹ (BMZ ID 2013 65 501) përmes Bankës për Zhvillim KFW dhe Agjencisë Zvicëranë për Zhvillim SECO, më 15.01.2016 u nënshkrua një kontratë konsulence ndërmjet KRU Gjakova dhe Asociacionit IGIP/Sachsen-Eisener/Hidroing. Projekti është i ndarë në Komponentën e Konsulencës së Implementimit (A), që përfshin shërbime projektimit detaj dhe të mbikëqyrjes së ndërtimit për investimet ITUN dhe rrjetin Kanalizimeve (vëllimi total i planifikuar është 16.8 milion €) dhe një Komponent për Masat Shoqëruese (B) që zhvillohet krahas (kohëzgjatja e përgjithshme 41 muaj) dhe synon shërbimet e ngritjes së kapaciteteve të KRU Gjakova. Ky raport ka të bëjë me Komponentën e Masave Shoqëruese (B).

Me këtë studim është rekomanduar procesi me llumin e aktivizuar pra opsioni i trajtimit përmes dekantimit primar dhe digjestimit anaerob.

Nevojat për infrastrukturë të re:

- Kater kolektorë kryesorë: Rahovec urban, Krushë e Madhe, Gexhë, Reti
- Tre impiante trajtimi (WWTP): njëri urban, tre ruralë
- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues në zonat problematike
- Ndarja e rrjetit fekal nga ai atmosferik

Sfidat kryesore në sistemin e kanalizimit:

1. Gjendja e dobët e kanalizimeve ekzistuese (rrjedhje të mëdha, bllokime)
2. Mungesa e dokumentacionit teknik për rrjetin ekzistues
3. Kycja e ujërave atmosferike në rrjetin fekal (sistem i përzier)
4. Mungesa totale e trajtimit (përveç Kramovik)
5. Shkarkimi direkt në trupa ujqorë pa respektim të standardeve mjedisore

¹ Raporti fillestar dhe koncept Raporti - Eliminimi i ujërave të ndotura në JP të Kosovës faza III, Prill 2017

3.7 Mjedisi

3.7.1 Ndotja e ajrit

Qytetin e Rahovecit e karakterizon një trafik i dendur, me numër të madh automjesh që qarkullojnë brenda ditës. Mungesa e vendeve të mjaftueshme për parkim, automjetet e vjetra dhe dendësia e qarkullimit ndikojnë drejtpërdrejt në ndotjen e ajrit dhe kanë pasoja për shëndetin e popullatës.

Tabela 13. Burimet kryesore të ndotjes së ajrit në Komunën e Rahovecit

Burimi	Ndotësit kryesorë
Trafiku i dendur urban	CO ₂ , NO _x , PM (pluhur i imët)
Ngrohja sezonale (thëngjill, dru)	SO ₂ , PM, blozë
Gurthyeset dhe minierat	Pluhur, PM ₁₀
Djegia e mbeturinave dhe gomave	Gazra serrë, dioksina
Rrugët e paasfaltuara	Pluhur

Problematika:

- Mungesa e pikave monitoruese të cilësisë së ajrit në komunë
- Cilësia e dobët e rrugëve kontribuon në nivelin e lartë të pluhurit
- Përdorimi i kufizuar i gazit natyror në amvisëri



Foto 2. Ndotja e ajrit nga djegia e lëndëve fosile për ngrohje, Rahovec

3.7.2 Ndotja e tokës

Toka, si resurs natyror jetik, duhet trajtuar me kujdes dhe në mënyrë të integruar për zhvillim të qëndrueshëm. Administrimi efikas i tokës, mbrojtja e tokës bujqësore nga degradimi dhe arritja e zhvillimit të qëndrueshëm mbeten sfida të mëdha për komunën.

Shkaktarët kryesorë të ndotjes së tokës:

- Shkarkimi i ujërave të zeza të patrajtuar në lumenj → ndotja e ujërave nëntokësore → ndotja e tokës
- Deponitë ilegale të mbeturinave
- Urbanizimi i pakontrolluar (ndërtime pa leje, veçanërisht në periudhën e pasluftës)
- Derivatet industriale dhe mbeturinat

Pasojat:

- Degradimi i tokës bujqësore
- Humbja e hapësirave të gjelbëruara
- Probleme në furnizimin me shërbime komunale për ndërtimet ilegale

3.7.3 Ndotja e ujit

Burimi kryesor i ndotjes së lumenjve në komunë janë ujërat e kanalizimit, si pasojë e sistemit të pakompletuar dhe joadekuat të menaxhimit të tyre. Shkarkimi i ujërave të zeza pa trajtim paraprak ka ndikim negativ në cilësinë e ujit, si dhe në jetën bimore dhe shtazore.

Sasia e shkarkimeve:

- Shkarkimi mesatar për banor: 16.46 m³/vit
- Shkarkimi total (41,799 banorë): ~688,011 m³/vit ose ~21.8 l/sek
- *(Pa llogaritur shkarkimet industriale)*

Lumenjtë më të ndotur:

Rimniku, Duhlllo, Sopniq, Bellaja – si rrjedhojë e hedhjes së mbeturinave dhe shkarkimit të ujërave të zeza.

Burimet e ndotjes:

1. Ujërat fekale nga ekonomitë familjare (shkarkimi direkt në lumenj)
2. Shkarkimet industriale (Veraria, Termosistemi dhe operatorë të tjerë)
3. Mbeturinat e ngurta të hedhura në shtretër lumenjsh
4. Ndotja bujqësore (pesticide, azot, fosfor)

Pasojat e ndotjes së ujit:

- Rrezik për shëndetin publik (sëmundje të transmetuara përmes ujit)

- Ndotja e ujërave nëntokësore që përdoren për pije
- Degradimi i biodiversitetit ujor
- Ndikimi negativ në bujqësi dhe blegtori

3.7.4 Vërshimet

Përmbytjet paraqesin rrezik të lartë për Komunën e Rahovecit, të shkaktuara nga kombinimi i disa faktorëve:

- Reshjet intensive, veçanërisht në pranverë dhe vjeshtë
- Shfrytëzimi ilegal i inerteve nga shtretërit e lumenjve
- Ndërtimet përgjatë brigjeve lumore
- Hedhja e mbeturinave në lumenj (bllokimi i rrjedhës)
- Ngushtimi i shtratit të lumenjve

Zonat më të rrezikuara:

Fortesë (Bellacërkë), Sapniq, Krushë e Madhe, Celinë, Çifllak, Dejnë, Xërxë, Gexhë, Radostë, Ratkoc, dhe pjesa jugore e qytetit të Rahovecit (Nënqyteti).

Periudhat e rrezikut:

- Dimër (janar–shkurt): reshje bore intensive dhe shkrirja e hovshme
- Pranverë (prill–maj) dhe vjeshtë (shtator–tëtor): reshje shiu të dendura

Tabela 14. Vërshimet e regjistruara në Komunën e Rahovecit (2018–2021)

Periudha	Ekonomitë e prekura	Dëmet materiale (€)	Lokacionet kryesore
Qershor 2018	129 familje	248,560	Rahovec, Krushë e Madhe, Nagave, Hoçë e Vogël, Brestoc, Sapniq, Fortesë, Celinë, Radostë, Ratkoc, Xërxë
2018–2021 (sipërfaqe bujqësore)	3,055 ha	9,151,758	Vërshime, breshër, shembje dheu
Maj 2020	42 familje	97,244	Rahovec, Pataqan i Poshtëm/Epërm, Drenoc, Kramovik
Janar 2021	201 familje + 7 biznese	530,948 + 48,425	Rahovec, Fortesë, Xërxë, Dabidol, Çifllak, Sopniq, Krushë e Madhe, Celinë, Opterushë, Dejnë, Ratkoc, Hoçë e Vogël, Radostë
Janar 2021 (infrastrukturë)	-	199,784	Rrugë, trotuare, kanalizime

Analiza e rreziqeve klimatike (sipas SECAP):

Sipas SECAP-it të Komunës së Rahovecit, rreziqet kritike janë thatësira e zgjatur dhe ulja e burimeve ujore, ndërsa përmbytjet lokale dhe valët e të nxehtit vlerësohen si rreziqe të larta.

Tabela 15. Matrica e rreziqeve klimatike për Komunën e Rahovecit

Rreziku	Probabiliteti	Ndikimi	Vlerësimi
Thatësira e zgjatur	Shumë i lartë	Shumë i lartë	Kritik
Përmbytjet lokale	Mesatar	I lartë	I lartë
Valët e të nxehtit	I lartë	I mesëm	I lartë
Ulja e burimeve ujore	I lartë	I lartë	Kritik
Erozioni i tokës	Mesatar	Mesatar	I moderuar



Foto 3. Vërshime në Rahovec

3.8 Problemet kryesore të identifikuara

Bazuar në analizën e gjendjes, identifikohen **gjashtë probleme kryesore** që strategjia duhet t'i adresojë me prioritet. Këto probleme shërbejnë si urë logjike midis analizës së situatës dhe objektivave strategjike:

Tabela 16. Problemet kryesore të identifikuara dhe pasojat e tyre

Nr.	Problemi	Pasojat kryesore	Urgjenca
1	Mungesa e impianteve të	Shkarkimi i ~925,000 m ³ /vit ujëra të patrajtuar në Drinin e Bardhë dhe degëzimet; rrezik serioz për shëndetin publik;	E lartë

	trajtimit të ujërave të zeza	ndotja e ujërave nëntokësore; degradimi i ekosistemeve ujore	
2	Infrastruktura e vjetëruar dhe e dëmtuar e kanalizimit	Rrjedhje të mëdha nga gypa; bllokime të shpeshta; mungesa e dokumentacionit teknik; kosto e lartë mirëmbajtjeje	E lartë
3	Mungesa e ndarjes së sistemit fekal nga ai atmosferik	Mbingarkesa e sistemit gjatë reshjeve intensive; vërshime urbane; ngarkesë e lartë hidraulike në impiantet e ardhshme	E mesme
4	Vërshimet e shpeshta dhe dëmet materiale	Dëme materiale të konsiderueshme (>10 milion € në periudhën 2018–2021); rrezik për jetën e qytetarëve; dëmtimi i tokës bujqësore	E lartë
5	Ndotja industriale e pakontrolluar	Shkarkime pa trajtim nga operatorët industrialë; ndotje e vazhdueshme e trupave ujorë; mungesa e monitorimit	E mesme
6	Mungesa e vetëdijes qytetare	Hedhja e mbeturinave në lumenj; keqpërdorimi i sistemit të kanalizimit; mospagesë e tarifave; mungesa e raportimit të problemeve	E mesme

3.9 Resurset Ujore dhe Infrastruktura Teknike

3.9.1 Sistemi i furnizimit me ujë

A) Burimet e furnizimit

Furnizimi me ujë për qytetarët e Komunës së Rahovecit sigurohet kryesisht nga Liqeni i Radoniqit, i cili menaxhohet nga KRU "Gjakova", me kapacitet akumulues prej 117 milion m³. Përveç Liqenit të Radoniqit, disa fshatra furnizohen edhe nga burimet e ujit nëntokësor.

Tabela 17. Burimet kryesore të ujit dhe kapaciteti i tyre

Burimi	Kapaciteti i prodhimit (m ³ /vit)	Kapaciteti i shfrytëzuar (m ³ /vit)	Prodhimi ditor (m ³ /ditë)
Pusi në Drenoc	90,000	21,600	59
Pusi në Senoc	70,000	30,000	82
Burimi në Hoçë të Madhe	75,000	21,600	59
Burimi në Opterushë	90,000	27,600	76
Totali	325,000	100,800	276

Tabela 18. Karakteristikat e burimeve ujore lokale

Emërtimi i burimit	Lartësia mbidetare (m)	Kapaciteti (l/sek)	Temperatura (°C)
Burimi i Rahovecit	390	5–8	13
Burimi i Zatriqit	920	5	13
Burimi i Opterushës	400	20	13
Burimi i Zaqishtit	415	15	13
Burimi i Hoçës së Madhe	420	10	14
Burimi i Sopotit	380	6	13

B) Rrjeti i gypsjiellësve kryesorë

Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të sistemit për furnizim me ujë të pijshëm në zonën e shërbimit të KRU "Gjakova" është 1,124.80 km, të regjistruara në sistemin ArcMAP.

Tabela 19. Gypsjellësit kryesorë të sistemit të furnizimit me ujë

Emërtimi i segmentit	Materiali dhe diametri	Gjatësia (m)
Gjakova II via Xërxë–Ura Terezive	GRP Ø800	7,061
Xërxë – Rezervuari Rahovec I	GRP Ø800	573
Rezervuari Rahovec I – SP Rahovec II	Çelik Ø400	2,204
Rezervuari Rahovec I – Rahovec II	PE Ø225	2,365
Rezervuari III – Hoçë e Madhe	PE Ø110	1,600
Ndarja Bellacërkë – Celinë	AC Ø400	1,600
Celinë – Krushë e Madhe	AC Ø350	2,025
Krushë e Vogël	AC Ø250	585
Xërxë – Gexhë	AC Ø300	3,218
Gexhë – Radostë (Malësi e Vogël)	AC Ø300	889
Radostë – Ratkoc	AC Ø250	3,257
Krushë e Vogël – Bregdri	AC Ø250	1,811

Burimi: Plani Zhvillimor Komunal i Rahovecit 2022–2030, KRU "Gjakova"

C) Stacionet e pompimit

Tabela 20. Stacionet e pompimit dhe gjendja aktuale

Emri i stacionit	Kapaciteti (Q)	Fuqia e instaluar (kW)	Nr. i pompave	Viti i instalimit	Gjendja
SP "Rahovec" I	Q=252 m³/h	P=132 kW	2+2	1985	Mirë
SP "Rahovec" II	Q=64 m³/h	P=37 kW	2	1985	Jo mirë
SP Pataqan	Q=37 m³/h	P=18 kW	2	2004	Mirë
SP Pataqan 1-2	Q=32 m³/h	P=15 kW	2	2004	Mirë
SP Vrajakë	Q=12 m³/h	P=5.5 kW	2	2006	Jo mirë
SP Bratatin	Q=1.5 m³/h	P=1.5 kW	2	2005	Mirë
SP Drenoc	Q=10 m³/h	P=7.5 kW	1	2006	Mirë
SP Senoc	Q=4.9 m³/h	P=5.5 kW	1	2006	Mirë
SP Opterushë	Q=30 m³/h	P=22 kW	1	2006	Mirë
SP Hoçë e Madhe	Q=5.0 m³/h	P=7.5 kW	1	2006	Mirë

D) Rezervuarët e ujit*Tabela 21. Rezervuarët dhe kapaciteti i tyre*

Emërtimi i rezervuarit	Kapaciteti (m ³)
Rezervuari në Rahovec I	1,500
Rezervuari në Rahovec II	2,500
Rezervuari në Rahovec III	250
Rezervuari në Rahovec IV	600
Rezervuari në Pataqan I	180
Rezervuari në Pataqan II	120
Rezervuari në Pataqan III	105
Rezervuari në Vrajkë	70
Rezervuari në Bratatin	50
Rezervuari në Opterushë	315
Rezervuari në Drenoc	300
Rezervuari në Polluzhë	400
Rezervuari në Senoc	300
Rezervuari në Hoçë e Madhe	200
Totali	6,890

E) Mbulimi me ujësjellës sipas vendbanimeve

Qytetarët e Komunës së Rahovecit furnizohen me ujë të pijshëm përmes tre formave:

1. **Sistemi qendror publik** – ujësjellësi i KRU "Gjakova"
2. **Sistemet lokale të pompimit** – ujësjellësit lokalë me pompa
3. **Puset individuale** – për zonat e pambuluara

Tabela 22. Mbulimi me ujësjellës sipas vendbanimeve

Nr.	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Sistemi	Menaxhimi
1	Rahovec	13,642	Publik	KRU Gjakova
2	Bellacërkë	1,582	Publik	KRU Gjakova
3	Bërnjakë	32	Publik	KRU Gjakova
4	Bratatin	265	Publik	KRU Gjakova
5	Brestoc	704	Publik	KRU Gjakova
6	Celinë	1,271	Publik	KRU Gjakova
7	Çifllak	1,130	Publik	KRU Gjakova
8	Dabidol	418	Publik	KRU Gjakova
9	Dejnë	1,225	Publik	KRU Gjakova
10	Drenoc	880	Pompim-Pusi	KRU Gjakova
11	Gexhë	503	Publik	KRU Gjakova
12	Hoçë e Madhe	508	Publik	KRU Gjakova
13	Hoçë e Vogël	987	Publik	KRU Gjakova
14	Kaznik	105	Individual	-
15	Kramovik	780	Publik	KRU Gjakova
16	Krushë e Madhe	3,183	Publik	KRU Gjakova
17	Mrasor	158	Individual	KRU Gjakova
18	Nagavc	623	Publik	KRU Gjakova
19	Nashpall	186	Publik	KRU Gjakova
20	Opterushë	1,091	Natyror	Burimi i fshatit (pompim autonom)
21	Pastaselë	757	Publik	KRU Gjakova
22	Pataqan i Epërm	244	Publik	KRU Gjakova

Nr.	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Sistemi	Menaxhimi
23	Pataqan i Poshtëm	672	Publik	KRU Gjakova
24	Petkoviq (Guri i Kuq)	746	Publik	KRU Gjakova
25	Polluzhë	517	Publik	KRU Gjakova
26	Radostë (Malësi e Vogël)	1,507	Publik	KRU Gjakova
27	Ratnoc	2,713	Publik	KRU Gjakova
28	Reti e Poshtme	170	Publik	KRU Gjakova
29	Retijë	492	Publik	KRU Gjakova
30	Sapniq	525	Publik	KRU Gjakova
31	Sarosh	0	Publik	KRU Gjakova
32	Senoc	585	Natyror-Pusi	KRU Gjakova
33	Vrajakë	625	Publik	KRU Gjakova
34	Xërxë	2,378	Publik	KRU Gjakova
35	Zatriq	196	Burim vetanak	Burimi i fshatit (kaptazh + pompim)
36	Zaqishtë	399	Burim vetanak	Burimi i fshatit (pompim autonom)
	Totali	41,799		

Shënim: këto të dhëna janë burim nga PZHK

Tabela 23. Përmbledhja e mbulimit me ujësjellës

Kategoria	Numri i banorëve	Përqindja
Me ujësjellës publik (KRU Gjakova)	37,578	89,9%
Pa ujësjellës publik	2,534	6,06%
Sisteme të pompimit lokal	1,687	4%
Totali	41,799	100%

F) Problematika kryesore në furnizimin me ujë

Furnizimi i banorëve të Komunës së Rahovecit me ujë të pijshëm aktualisht përcillet me probleme të konsiderueshme:

- **Humbjet e larta në sistem:** Rreth 57% e ujit të prodhuar humbet në rrjetin shpërndarës
- **Keqpërdorimi:** Gjatë periudhës së nxehtë, uji i pijshëm shpesh keqpërdoret për ujitjen e tokave
- **Kyçjet ilegale:** Kontribuojnë në humbjet dhe në mosmatjen e saktë të konsumit
- **Inkasimi i ulët:** Shkalla e inkasimit vlerësohet të jetë 65–70%
- **Vështirësitë sezonale:** Gjatë muajve të verës shfaqen probleme në zonat e larta dhe pikat e largëta

Parametrat e konsumit:

- Konsumimi mesatar ditor për banor: 200–250 litra/ditë
- Norma e shpenzimeve për Rahovec: 200 l/banor/ditë
- Norma e shpenzimeve për vendbanime rurale: 150 l/banor/ditë

3.9.2 Sistemi i kanalizimit

A) Mbulimi me rrjet kanalizimi

Në Komunën e Rahovecit, shumica e vendbanimeve kanë qasje në kanalizim të ujërave të zeza, megjithëse mungon trajtimi i tyre. Gjendja e kanalizimeve ekzistuese është e dobët dhe besohet se ndodhin rrjedhje të mëdha.

Tabela 24. Mbulimi me kanalizim sipas vendbanimeve

Nr.	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Kanalizim
1	Rahovec	13,642	Po
2	Bellacërkë	1,582	Po – pjesërisht
3	Bërnjakë	32	Po
4	Bratatin	265	Po
5	Brestoc	704	Po
6	Celinë	1,271	Po
7	Çifllak	1,130	Po
8	Dabidoi	418	Po
9	Dejnë	1,225	Po
10	Drenoc	880	Po
11	Gexhë	503	Po
12	Hoçë e Madhe	508	Po
13	Hoçë e Vogël	987	Po
14	Kaznik	105	Jo
15	Kramovik	780	Po
16	Krushë e Madhe	3,183	Po
17	Mrasor	158	Po
18	Nagavc	623	Po
19	Nashpall	186	Po
20	Opterushë	1,091	Po
21	Pastaselë	757	Po
22	Pataqan i Epërm	244	Po
23	Pataqan i Poshtëm	672	Po
24	Petkoviq (Guri i Kuq)	746	Po
25	Polluzhë	517	Po
26	Radostë (Malësi e Vogël)	1,507	Po
27	Ratkoc	2,713	Po
28	Reti e Poshtme	170	Po
29	Retijë	492	Po
30	Sapniq	525	Po
31	Sarosh	0	Po
32	Senoc	585	Po
33	Vrajakë	625	Po
34	Xërxë	2,378	Po
35	Zatriq	196	Po
36	Zaqishtë	399	Po
	Totali	41,799	

Tabela 25. Përmbledhja e mbulimit me kanalizim

Kategoria	Numri i banorëve	Përqindja
Me kanalizim të plotë	40,112	95.96%
Me kanalizim pjesërisht	1,582	3.78%
Pa kanalizim	105	0.25%
Totali	41,799	100%

B) Gjendja aktuale dhe problemet

Trajtimi i ujërave të zeza:

- Të gjitha kanalizimet ekzistuese shkarkojnë në lumenj ose përroska pa asnjë trajtim paraprak
- Përfundim: Fshati Kramovik, ku funksionon impianti i sistemit Lagun
- Mungesa e trajtimit shkakton ndotje të lumenjve, tokës dhe ujërave nëntokësore

Infrastruktura e nevojshme (sipas PZHK):

Për shkak të konfiguracionit të terrenit, parashihen:

- 3 kolektorë kryesorë për grumbullimin e ujërave fekale
- 3 impiante trajtimi për trajtimin e ujërave para shkarkimit në Drinin e Bardhë

Kolektorët e planifikuar:

1. Kolektori i Krushës së Madhe – prioritet i parë
2. Kolektori i Gexhës – prioritet i dytë
3. Kolektori urban i Rahovecit – për zonën qendrore

3.9.3 Sistemi i ujitjes bujqësore**A) Format e ujitjes**

Në praktikën bujqësore të Komunës së Rahovecit, përdoren tri sisteme kryesore të ujitjes:

- Sistemi i ujitjes me rrjedhje të lirë
- Sistemi i ujitjes në formë shiu (spërkatje)
- Sistemi i ujitjes së lokalizuar (me pika)

Ujitja e vendbanimeve bëhet kryesisht nga KRU "Radoniqi-Dukagjini" përmes rezervuarit në "Rezinë".

B) Mbulimi me sistem ujitjeje

Tabela 26. Vendbanimet sipas sistemit të ujitjes

Nr.	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Sistemi i ujitjes
1	Rahovec	13,642	Jo
2	Bellacërkë (Fortesë)	1,582	Po
3	Bërnjakë	32	Po
4	Bratatin	265	Pjesërisht
5	Brestoc	704	Jo
6	Celinë	1,271	Po
7	Çifllak	1,130	Po
8	Dabidol	418	Po
9	Dejnë	1,225	Po
10	Drenoc	880	Jo
11	Gexhë	503	Po
12	Hoçë e Madhe	508	Jo
13	Hoçë e Vogël	987	Jo
14	Kaznik	105	Jo
15	Kramovik	780	Po
16	Krushë e Madhe	3,183	Po
17	Mrasor	158	Jo
18	Nagavc	623	Pjesërisht
19	Nashpall	186	Jo
20	Opterushë	1,091	Jo
21	Pastaselë	757	Jo
22	Pataqan i Epërm	244	Jo

23	Pataqan i Poshtëm	672	Jo
24	Petkoviq (Guri i Kuq)	746	Jo
25	Polluzhë	517	Jo
26	Radostë (Malësi e Vogël)	1,507	Po
27	Ratkoc	2,713	Po
28	Reti e Poshtme	170	Jo
29	Retijë	492	Jo
30	Sapniq	525	Po
31	Sarosh	0	Po
32	Senoc	585	Jo
33	Vrajakë	625	Jo
34	Xërxë	2,378	Po
35	Zatriq	196	Jo
36	Zaqishtë	399	Jo
	Totali	41,799	

Tabela 27. Përmbledhja e mbulimit me ujë

Kategoria	Numri i banorëve (zona)	Përqindja
Me sistem ujë	17,512	41%
Pa sistem ujë	23,664	59%
Totali	41,799	100%

C) Sipërfaqet e ujitura (2021)

Tabela 28. Sipërfaqet e ujitura sipas vendbanimeve (2021)

Vendbanimi	Sipërfaqja e ujitur (ha)
Krushë e Madhe	530
Radostë (Malësi e Vogël)	345
Ratkoc	330
Bellacërkë (Fortesë)	197
Xërxë	197
Celinë	185
Çifllak	152
Dejnë	120
Gexhë	98
Kramovik	90
Dabidol	80
Sapniq	62
Rahovec	35
Nagavc	23
Polluzhë	20
Pataqan i Poshtëm	7
Totali	2,888

Burimi: Drejtoria e Bujësisë, Komuna e Rahovecit, 2021

3.9.4 Drenazhimi dhe kullimi

A) Nevoja për drenazhim

Vendbanimet e Komunës së Rahovecit, përveç ujitjes, kanë nevojë edhe për sistemin e drenazhimit të sipërfaqeve bujqësore. Drenazhimi është i nevojshëm për:

- Largimin e ujërave sipërfaqësorë të krijuara nga reshjet
- Largimin e ujërave nëntokësore kur ka tepricë
- Krijimin e kushteve të favorshme për bimët (ajrosja e zonës rrënjore)

B) Llojet e kanaleve të nevojshme

Për ruajtjen e tokave bujqësore nevojiten dy lloje kanalesh:

1. Kanalet për evakuim të ujit – largimi i ujërave sipërfaqësore
2. Kanalet për kullim të ujit – drenazhimi i ujërave nëntokësore

C) Pikat kritike nga vërshimet

Territori i Komunës së Rahovecit i nënshtrohet zonës me reshje intensive të shiut, me mesatare vjetore 650–700 l/m². Kur kësaj i shtohet edhe shkrija e borës, vërshimet janë dukuri mjaft e pranishme.

Vendbanimet më të rrezikuara nga vërshimet:

Prioriteti	Vendbanimet
I lartë	Bellacërkë (Fortesë), Xërxë, Celinë, Krushë e Madhe
Mesatar	Kramovik, Çifllak, Dabidol, Dejnë, Ratkoc, Radostë (Malësi e Vogël), Gexhë




Figura 4. Harta e rrjetit të ujësjellës – Furnizimi me ujë të pijshëm




Figura 5. Harta e rrjetit të kanalizimit – Qasja në rrjetin e kanalizimit

4. ANALIZA SWOT

4.1 Matrica SWOT

Analiza SWOT përmbledh gjendjen aktuale të sektorit të ujërave të zeza në Komunën e Rahovecit dhe identifikon faktorët e brendshëm (përparësitë dhe dobësitë) si dhe faktorët e jashtëm (mundësitë dhe kërcënimet) që ndikojnë në zbatimin e strategjisë.

Tabela 29. Matrica SWOT për menaxhimin e ujërave të zeza në Komunën e Rahovecit

PËRPARËSITË (Strengths)	DOBËSITË (Weaknesses)
• Mbulim i lartë me rrjet kanalizimi (95.69% e popullsisë)	• Mungesa totale e impianteve të trajtimit (përveç Kramovik)
• Burime të pasura ujore (Drini i Bardhë, burime nëntokësore)	• Infrastrukturë e vjetëruar dhe e dëmtuar
• Pozitë e favorshme gjeografike (gravitet për transport)	• Mungesa e ndarjes fekale/atmosferike
• Ekzistenca e KRU "Gjakova" si operator rajonal me përvojë	• Humbje të larta në sistemin e ujësjellësit (~57%)
• Përvoja nga impianti ekzistues lagun në Kramovik	• Mungesa e dokumentacionit teknik për rrjetin
• Angazhimi i deklaruar i Komunës për përmirësim	• Kapacitete të kufizuara teknike dhe financiare në nivel lokal
• Ekzistenca e dokumenteve strategjike lokale (PLVM, SECAP)	• Shkalla e ulët e mbledhjes së tarifave
MUNDËSITË (Opportunities)	KËRCËNIMET (Threats)
• Mbështetja e donatorëve ndërkombëtarë (BE, BERZH, KfW)	• Ndryshimet klimatike (reshje intensive, thatësira, vërshime)
• Fondet IPA dhe instrumentet e tjera të BE-së	• Rritja e ndotjes nga zhvillimi ekonomik
• Teknologjitë e reja të trajtimit (impiante modulare, efikase)	• Presioni demografik dhe urbanizimi i pakontrolluar
• Strategjia Shtetërore për Ujëra si kornizë mbështetëse	• Mungesa e mundshme e financimeve ose vonesa
• Bashkëpunimi rajonal me komunat fqinje në menaxhimin e pellgut	• Degradimi i mëtejshëm i infrastrukturës ekzistuese
• Mundësia e partneriteteve publiko-private (PPP)	• Rezistenca e mundshme ndaj rritjes së tarifave
• Integrimi i masave klimatike me ato mjedisore (SECAP)	• Mungesa e koordinimit ndër-institucional

4.2 Konkluzionet strategjike

Nga analiza SWOT dalin katër konkluzione strategjike që orientojnë ndërhyrjet e kësaj strategjie:

Konkluzion 1: Prioritet i lartë për ndërtimin e impianteve të trajtimit

Përparësia e mbulimit të lartë me rrjet kanalizimi mbetet e pavlefshme pa trajtimin e ujërave të zeza. Ndërtimi i tre impianteve (njëri urban dhe dy ruralë) është kusht themelor për mbrojtjen e shëndetit publik, reduktimin e ndotjes së trupave ujqorë dhe përmbushjen e standardeve të Direktivës 91/271/EEC të BE-së. Kjo ndërhyrje duhet të ketë prioritet absolut në fazën e parë të strategjisë.

Konkluzion 2: Rehabilitimi i infrastrukturës si parakusht për efikasitet

Investimet në impiante trajtimi do të jenë joefikase nëse rrjeti ekzistues i kanalizimit vazhdon të ketë rrjedhje të mëdha dhe bllokime. Rehabilitimi i segmenteve kritike dhe dokumentimi teknik i rrjetit duhet të ecë paralelisht me ndërtimin e impianteve, për të siguruar që ujërat e grumbulluara arrijnë në pikat e trajtimit.

Konkluzion 3: Shfrytëzimi aktiv i mundësive të financimit ndërkombëtar

Donatorët ndërkombëtarë (BE, KfW, BERZH) janë të gatshëm të mbështesin projekte të ujërave të zeza, sidomos ato që kontribuojnë në harmonizimin me standardet evropiane. Komuna dhe KRU duhet të përgatiten me projekte të gatshme për financim ("bankable projects") dhe të aplikojnë në mënyrë proaktive në thirrjet e disponueshme.

Konkluzion 4: Integrimi i menaxhimit të rrezikut nga vërshimet

Ndarja e sistemit fekal nga ai atmosferik dhe ndërtimi i kanaleve kulluese janë thelbësorë për të reduktuar dëmet nga vërshimet dhe për të mbrojtur investimet në infrastrukturë. Ky komponent duhet të integrohet në strategji si masë parandaluese dhe jo vetëm reaguese.

5. OBJEKTIVAT DHE MASAT

5.1 Objektiva e përgjithshme

Të sigurohet trajtimi i të paktën 80% të ujërave të zeza të Komunës së Rahovecit dhe të reduktohet ndjeshëm ngarkesa ndotëse në trupat ujqorë deri në vitin 2030.

Kjo objektiv e përgjithshme do të arrihet përmes pesë objektivave specifike, secila me masa konkrete, indikatorë të matshëm, targete, afate dhe përgjegjësi të qarta. Për disa indikatorë teknikë që varen nga studimet e fizibilitetit dhe projektet e detajuara, vlerat do të përcaktohen pas përfundimit të këtyre studimeve (shënuar si "TBD – pas projektimit detaj").

5.2 Objektivi specifik 1: Rritja e investimeve infrastrukturore për mbrojtjen e ujërave

Ky objektiv synon mobilizimin e burimeve financiare dhe hartimin e projekteve të nevojshme për infrastrukturën e trajtimit të ujërave të zeza. Pa investime të planifikuara dhe të koordinuara, ndërhyrjet kapitale nuk mund të realizohen. Masat e këtij objektivi fokusohen në përgatitjen e bazës së nevojshme për zbatimin e investimeve kapitale në fazat e mëvonshme.

Tabela 30. Masat dhe treguesit për Objektivin Specifik 1

Kodi	Masa	Indikatori	Targeti	Afati	Përgjegjësi	Burimi financiar
1.1.1	Vlerësimi i ndikimit buxhetor në Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) për nevojat e investimeve në mbrojtjen e ujërave	Vlerësimi i përfunduar (Po/Jo)	Po	Q4 2025	Komuna e Rahovecit (Drejtoria e Financave)	Buxheti komunal
1.1.2	Hartimi i projekteve për mbrojtjen e lumenjve dhe parandalimin e rreziqeve nga vërshimet	Numri i projekteve të hartuara dhe të gatshme për financim	≥2 projekte	Q4 2026	Komuna (Drejtoria e Infrastrukturës)	Donatorë, buxheti komunal
1.1.3	Identifikimi dhe analiza e plotë e burimeve ujore dhe gjendjes së tyre	Raporti i plotë i miratuar (Po/Jo)	1 raport	Q2 2026	Komuna, KRU "Gjakova"	Donatorë
1.1.4	Harmonizimi i planeve të investimeve dhe menaxhimit të ujërave të zeza mes Komunës dhe KRU	Marrëveshja e bashkëpunimit e nënshkruar (Po/Jo)	Po	Q2 2026	Komuna, KRU "Gjakova"	Pa kosto direkte

5.3 Objektiv specifik 2: Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimi i impianteve të trajtimit

Ky objektivi është bërthama e strategjisë dhe synon krijimin e infrastrukturës së nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza. Masat përfshijnë ndërtimin e impianteve të trajtimit, kolektorëve kryesorë dhe rehabilitimin e rrjetit ekzistues. Realizimi i këtij objektivi do të mundësojë trajtimin e ujërave të zeza për shumicën e popullsisë së komunës dhe do të reduktojë ndjeshëm shkarkimet e patrajtuar në trupa ujorë.

Tabela 31. Masat dhe treguesit për Objektivin Specifik 2

Kodi	Masa	Indikatori	Targeti	Afati	Përgjegjësi	Burimi financiar
2.1.1	Përfshirja në KAB e investimeve për kanalizim dhe trajtim	Shuma e planifikuar në KAB (€/vit)	≥500,000 €/vit	2025–2031 (vjeter)	Komuna e Rahovecit (Drejtoria e Financave)	Buxheti komunal

2.1.2	Hartimi i projektit teknik për kolektorin dhe WWTP urban (Rahovec)	Projekti i gatshëm për financim dhe prokurim (Po/Jo)	1 projekt i plotë	Q4 2025	Komuna, KRU "Gjakova"	Donatorë, buxheti
2.1.3	Ndërtimi i impiantit kryesor urban të trajtimit (WWTP Rahovec)	Impianti i ndërtuar dhe funksional (Po/Jo)	1 impiant (kapacitet: ~15,000 BE)	Q4 2027	Komuna, KRU, kontraktori	Grante ndërkombëtare (indikative ~70%), bashkëfinancim lokal (~30%)
2.1.4	Ndërtimi i dy impianteve rurale të trajtimit (Krushë e Madhe, Gexhë)	Numri i impianteve funksionale	2 impiante (kapacitet: ~4,000 BE secili)	Q4 2029	Komuna, KRU	Grante (indikative ~60%), PPP ose buxhet (~40%)
2.1.5	Rehabilitimi i rrjetit ekzistues të kanalizimit në zonat kritike	Km rrjet i rehabilituar	≥15 km	Q4 2031	KRU "Gjakova"	Buxheti, tarifa, grante
2.1.6	Ndërtimi i kolektorëve kryesorë (urban dhe rural)	Km kolektorë të ndërtuar	8–12 km (TBD – pas projektimit detaj)	Q4 2029	Komuna, KRU	Grante, buxheti
2.1.7	Hartimi dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Llumit (grumbullim, trashje/tharje, stabilizim, transport dhe destinacion final i autorizuar), i integruar me O&M të WWTP-ve.	Plani i llumit i aprovuar + kontrata/procedura operative në fuqi	1 plan i aprovuar + zbatim operacion al në të gjitha WWTP-të	Q4 2027	Komuna, KRU "Gjakova", Operatorët e WWTP (O&M), AMMK (mbikëqyrje)	Grante / buxhet komunal / tarifa O&M (sipas modelit të operimit)

Shënim për kapacitetet e impianteve: BE = Banorë Ekuivalent. Kapaciteti përfundimtar do të përcaktohet në studimin e fizibilitetit dhe projektin teknik.

Shënim për indikatorin 2.1.6: Gjatësia e saktë e kolektorëve (në km) do të përcaktohet pas përfundimit të projektit teknik të detajuar (masa 2.1.2), i cili do të përfshijë trasimin, dimensionimin dhe specifikat teknike. Bazuar në vlerësimet paraprake dhe konfigurimin aktual të rrjetit në komunë, parashikohet një gjatësi orientuese prej 8–12 km për kolektorët kryesorë; vlera finale përcaktohet pas projektimit.

Shënim për burimet e financimit (2.1.3 dhe 2.1.4): Përqindjet e financimit janë indikative dhe të synuara. Ndarja përfundimtare do të përcaktohet pas nënshkrimit të marrëveshjeve të financimit me donatorët dhe/ose partnerët e PPP-së.

5.4 Objektivi specifik 3: Zvogëlimi i ndotjes industriale të ujërave

Ky objektivi synon identifikimin, monitorimin dhe kontrollin e shkarkimeve industriale në trupa ujorë, përmes masave rregullatore dhe teknike. Në Komunën e Rahovecit operojnë disa ndërmarrje industriale (Veraria Stone Castle, Bodrumi I Vjeter, Termosistemi, etj.) që shkarkojnë ujëra të ndotura pa trajtim adekuat. Kontrolli i këtyre shkarkimeve është i domosdoshëm për të mbrojtur cilësinë e ujërave dhe për të siguruar funksionimin efektiv të impianteve të ardhshme të trajtimit.

Tabela 32. Masat dhe treguesit për Objektivin Specifik 3

Kodi	Masa	Indikatori	Targeti	Afati	Përgjegjësi	Burimi financiar
3.1.1	Identifikimi i ndotësve industrialë dhe krijimi i regjistrit të shkarkimeve	Regjistri i ndotësve i krijuar dhe i publikuar (Po/Jo)	1 regjistër me të paktën 15 operatorë (sipas të dhënave paraprake komunale dhe inspektoratit)	Q4 2025	Komuna (Drejtoria UPM e Mjedisit), AMMK	Buxheti komunal
3.1.2	Vlerësimi i ndikimit të shkarkimeve industriale në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore	Raporti i vlerësimit i përfunduar (Po/Jo)	1 raport	Q4 2026	AMMK, Komuna	Donatorë, buxheti
3.1.3	Zbatimi i masave administrative dhe ndëshkuese për ndotësit industrialë	Numri i inspektimeve të kryera; Numri i masave të shqiptuara	≥20 inspektime/vit; ≥5 masa/vit (gjyba, vërejtje, ndalim)	2025–2030 (vjeter)	Inspektorati komunal, AMMK	Buxheti komunal; të hyrat nga gjybat

3.1.4	Vendosja e kërkesave për paratrajtim dhe nënshkrimi i marrëveshjeve me shkarkuesit industrialë	Numri i operatorëve me marrëveshje paratrajtimi	≥5 operatorë (duke filluar me ndotësit më të mëdhenj: Veraria, Termoventi, etj.)	Q4 2028	Komuna, AMMK, operatorët	Operatorët industrialë (investim privat)
-------	--	---	--	---------	--------------------------	--

Shënim për targetet: Targetet janë përcaktuar bazuar në të dhënat paraprake të Komunës dhe inspektoratit për numrin e operatorëve industrialë në komunë. Pas krijimit të regjistrit (masa 3.1.1), targetet mund të rishikohen në rishikimin afatmesëm të strategjisë (2027).

5.5 Objektivi specifik 4: Përmirësimi i infrastrukturës së lumenjve dhe parandalimi i vërshimeve

Ky objektivi lidh menaxhimin e ujërave të zeza me mbrojtjen nga vërshimet, duke adresuar ndarjen e sistemit fekal nga ai atmosferik dhe ndërtimin e infrastrukturës mbrojtëse. Vërshimet e shpeshta në Komunën e Rahovecit kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale dhe janë të lidhura drejtpërdrejt me mungesën e kanaleve atmosferike të ndarë dhe me bllokimin e shtretërve të lumenjve.

Masa 4.1.1 (zgjerimi i shërbimit të mbledhjes së mbeturinave) trajtohet si masë mbështetëse për këtë objektivi, pasi mbeturinat e pagrumbulluara bllokojnë kanalet atmosferike dhe shtretërit e lumenjve, duke shkaktuar vërshime që përziejnë ujërat fecale me rrjedhat sipërfaqësore dhe rrisin rrezikun shëndetësor e mjedisor.

Tabela 33. Masat dhe treguesit për Objektivin Specifik 4

Kodi	Masa	Indikatori	Targeti	Afati	Përgjegjësi	Burimi financiar
4.1.1	Zgjerimi i shërbimit të mbledhjes së mbeturinave dhe caktimi i deponive inerte (masë mbështetëse)	Përqindja e popullsisë së mbuluar me shërbim	≥95%	Q4 2028	Komuna, kompania e mbeturinave	Buxheti, tarifa
4.1.2	Hartëzimi i plotë i pikave kritike të rrezikut nga vërshimet dhe përgatitja e hartës së lumenjve	Harta e rrezikut e miratuar (Po/Jo)	1 hartë e plotë, e integruar në planin hapësinor	Q2 2026	Komuna, IHMK	Donatorë, buxheti
4.1.3	Ndërtimi i mureve mbrojtëse në zonat kritike (Fortesë, Xërxë, Krushë e Madhe)	Metër linear mure të ndërtuara	≥2,000 m	Q4 2029	Komuna	Grante (indikative ~80%), buxheti (~20%)
4.1.4	Ndërtimi i kanaleve kulluese dhe sistemeve të drenazhimit	Km kanale të ndërtuara	≥5 km	Q4 2030	Komuna	Grante
4.1.5	Ndërtimi dhe rehabilitimi i kanaleve atmosferike	Km kanale atmosferike	≥10 km (duke filluar me zonën urbane)	Q4 2031	Komuna, KRU	Buxheti, grante

	(të ndarë nga sistemi fekal)					
4.1.6	Përfshirja e komunitetit në parandalimin e bllokimeve dhe heqjen e pengesave në lumenj	Numri i aktiviteteve vullnetare me komunitetin	≥6 aktivitete/vit	2025–2031 (vjetor)	Komuna, OJQ lokale	Buxheti komunal

5.6 Objektivi specifik 5: Ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen e ujërave

Ky objektivi synon ndryshimin e sjelljes së qytetarëve përmes edukimit, informimit dhe angazhimit aktiv në mbrojtjen e burimeve ujore dhe përdorimin e duhur të infrastrukturës. Vetëdija e ulët qytetare kontribuon në hedhjen e mbeturinave në lumenj, keqpërdorimin e sistemit të kanalizimit dhe mospagesën e tarifave. Masat e këtij objektivi synojnë të adresojnë këto probleme përmes qasjeve edukative dhe komunikuese.

Tabela 34. Masat dhe treguesit për Objektivin Specifik 5

Kodi	Masa	Indikatori	Targeti	Afati	Përgjegjësi	Burimi financiar
5.1.1	Iniciativa të përbashkëta me shkollat për promovimin e ruajtjes së mjedisit dhe ujërave	Numri i shkollave të përfshira; Numri i nxënësve të arritur	≥20 shkolla; ≥3,000 nxënës	Q4 2026	Komuna (DKA), OJQ	Buxheti, donatorë
5.1.2	Takime periodike me komunitetet lokale për rolin e tyre në mbrojtjen e ujërave	Numri i takimeve të realizuara/vit	≥12 takime/vit (≥1 për çdo muaj)	2025–2031 (vjetor)	Komuna, KRU	Buxheti komunal
5.1.3	Sigurimi i politikave favorizuese dhe subvencionimi i aktiviteteve parandaluese	Numri i nismave të subvencionuara (pastrime, pyllëzime, etj.)	≥3 nisma/vit	2025–2030 (vjetor)	Komuna	Buxheti komunal
5.1.4	Fushata mediatike për shkaktarët dhe rreziqet nga ndotja dhe vërshimet	Numri i fushatave të realizuara/vit; Arritura (numri i personave të informuar)	≥2 fushata/vit; ≥10,000 persona të arritur/fushatë	2025–2031 (vjetor)	Komuna, media lokale	Buxheti komunal
5.1.5	Krijimi dhe operacionalizimi i mekanizmit për raportimin e ndotjes nga qytetarët	Mekanizmi funksional (linjë telefonike + formular online) (Po/Jo); Numri i raportimeve të trajtuara	Po; ≥50 raportime/vit të trajtuara	Q4 2025 (krijimi); 2026–2030 (operimi)	Komuna, KRU	Buxheti komunal

5.7 Përmbledhja e objektivave dhe lidhja me fazat

Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të objektivave specifike, indikatorëve kryesorë dhe lidhjen e tyre me fazat e zbatimit të strategjisë. Popullsia target për trajtim ($\geq 80\%$) është llogaritur bazuar në popullsinë rezidente të komunës (~55,000 banorë sipas vlerësimit ASK 2022), që korrespondon me ~44,000 banorë të mbuluar me trajtim deri në vitin 2031.

Tabela 35. Përmbledhja e objektivave, indikatorëve kryesorë dhe fazave

Objekti i specifik	Indikator i kryesor	Targeti 2030	Faza kryesore
OS1: Investimet infrastrukturore	Projekte të hartuara dhe financime të siguruar	≥ 4 projekte; $\geq 70\%$ financim i siguruar	Faza I (2025–2027)
OS2: Rrjeti dhe impiantet	Popullsia me qasje në trajtim	$\geq 80\%$ (~44,000 banorë nga ~55,000 rezidentë)	Faza I + II
OS3: Ndotja industriale	Operatorë me marrëveshje paratrajtimi	≥ 5 operatorë	Faza II (2028–2029)
OS4: Vërshimet	Reduktimi i dëmeve materiale	$\geq 50\%$ reduktim krahasuar me periudhën 2018–2021	Faza II + III
OS5: Vetëdija qytetare	Shkolla dhe qytetarë të arritur	≥ 20 shkolla; $\geq 30,000$ qytetarë	2025–2031 (vazhdueshëm)

6. INVESTIMET NË INFRASTRUKTURË DHE PRIORITIZIMI

6.1 Rëndësia e investimeve në infrastrukturë

Investimet në infrastrukturën e trajtimit të ujërave të zeza janë jetike për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe për të adresuar sfidat kryesore që përballen komunitetet në Komunën e Rahovecit. Sektori i ujërave të zeza ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së popullsisë dhe ka rol kritik në katër dimensione:

Shëndeti publik: Mungesa e infrastrukturës adekuate për trajtimin e ujërave të zeza shkakton përhapjen e sëmundjeve të transmetuara përmes ujit. Investimet në trajtim reduktojnë ndjeshëm rrezikun nga infeksionet gastrointestinale dhe krijojnë kushte më të mira higjienike për popullatën.

Mbrojtja e mjedisit: Trajtimi i ujërave të zeza ndihmon në ruajtjen e burimeve natyrore, duke parandaluar ndotjen e lumenjve, përrojave dhe ujërave nëntokësore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për pellgun e Drinit të Bardhë, një nga burimet kryesore ujore në Kosovë që kalon nëpër disa komuna.

Zhvillimi ekonomik: Infrastrukturat e avancuara të menaxhimit të ujërave mbështesin zhvillimin e industrive, veçanërisht agroindustrinë dhe vreshtarinë, dhe përmirësojnë atraktivitetin e Rahovecit për investime të reja dhe turizëm rural.

Përputhja me standardet evropiane: Në kuadrin e aspiratave të Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian, zbatimi i standardeve të BE-së për trajtimin e ujërave të zeza (Direktiva 91/271/EEC) është i domosdoshëm. Investimet në këtë sektor ndihmojnë në harmonizimin me direktivat evropiane dhe rritjen e besueshmërisë së vendit në nivel ndërkombëtar.

6.2 Matrica e prioritizimit të investimeve

Për të garantuar përdorimin më efikas të burimeve të kufizuara financiare, është krijuar një matricë prioritizimi që reflekton ndikimin social, ekonomik dhe mjedisor të investimeve. Kjo matricë bazohet në katër kritere kryesore, të ponderuara sipas rëndësisë së tyre:

1. **Urgjenca e nevojës (30%):** Zonat me ndotje të lartë ose me ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin publik kanë përparësi. Ujërat e zeza që shkarkohen pa trajtim dhe ndotin pellgjet ujore kryesore konsiderohen prioritare.
2. **Numri i përfituesve (25%):** Zonat urbane me dendësi të lartë të popullsisë, si qyteti i Rahovecit, kanë prioritet për të maksimizuar ndikimin pozitiv mbi komunitetin.
3. **Efikasiteti financiar dhe teknik (25%):** Projektet që sigurojnë trajtim efektiv të ujërave me kosto të ulët operationale dhe kapacitete të larta renditen më lart në prioritet.
4. **Ndikimi mjedisor (20%):** Projektet me potencial për të reduktuar ndjeshëm ndotjen dhe për të mbrojtur biodiversitetin dhe burimet ujore konsiderohen me prioritet të lartë.

Tabela 36. Matrica e prioritizimit të investimeve sipas zonave

Kriteri	Pesha (%)	Zona Urbane (Rahovec)	Zona Rurale	Zona Industriale
Urgjenca e nevojës	30%	9	7	8
Numri i përfituesve	25%	10	6	8
Efikasiteti financiar	25%	8	9	9
Ndikimi mjedisor	20%	9	8	7
Totali i ponderuar	100%	8.95	7.45	8.05

Përfundimi i prioritizimit: Zona urbane (qyteti i Rahovecit) ka prioritet më të lartë për investime, e ndjekur nga zona industriale dhe pastaj zona rurale. Megjithatë, zbatimi do të bëhet në mënyrë të integruar, duke siguruar që të gjitha zonat të përfitojnë brenda periudhës së strategjisë.

6.3 Lidhja e investimeve me objektivat strategjike

Çdo investim i planifikuar është i lidhur drejtpërdrejt me objektivat specifike të strategjisë. Kjo siguron koherencë mes planifikimit strategjik dhe zbatimit operacional, si dhe mundëson monitorimin e progresit ndaj objektivave.

Tabela 37. Lidhja Objektiv – Investim – Kosto – Afat – Zonë

Objektivi	Investimi	Kosto (€)	Faza/Afati	Zona
Obj. 2.1.3	WWTP kryesor urban (Rahovec)	3,500,000	I (2025–2027)	Urbane
Obj. 2.1.6	Kolektorët kryesorë urbanë	2,500,000	I (2025–2027)	Urbane
Obj. 2.1.5	Rehabilitimi urgjent i rrjetit ekzistues	2,500,000	I (2025–2027)	Urbane/Rurale
Obj. 2.1.4	WWTP rural Krushë e Madhe	2,300,000	II (2028–2029)	Rurale

Obj. 2.1.4	WWTP rural Gexhë	2,300,000	II (2028–2029)	Rurale
Obj. 2.1.6	Kolektorët ruralë	900,000	II (2028–2029)	Rurale
Obj. 4.1.5	Kanale atmosferike dhe kulluese	1,500,000	III (2029–2031)	Urbane/Rurale
Obj. 4.1.3	Mure mbrojtëse kundër vërshimeve	1,200,000	III (2029–2031)	Zonat e rrezikuara
Obj. 4.1.5	Ndarja progresive fekale/atmosferike	800,000	III (2029–2031)	Urbane
TOTALI		17,500,000		

6.4 Fazat e zbatimit dhe afatet kohore

Zbatimi i investimeve është planifikuar në tre faza kryesore, duke filluar me ndërhyrjet më urgjente dhe me ndikim më të madh, dhe duke vazhduar me zgjerimin progresiv të sistemit.

Tabela 38. Fazat e zbatimit të investimeve

Faza	Periudha	Fokusi kryesor	Ndërhyrjet	Kosto (€)
Faza I	2025–2027	Trajtimi urban dhe kolektorët kryesorë	WWTP urban Rahovec, kolektorët urbanë, rehabilitimi urgjent i rrjetit	8,500,000
Faza II	2028–2029	Trajtimi rural dhe zgjerimi	2 WWTP rurale (Krushë e Madhe, Gexhë), kolektorë ruralë, zgjerimi i rrjetit periferik	5,500,000
Faza III	2029–2031	Ndarja dhe mbrojtja	Ndarja fekale/atmosferike, kanale atmosferike dhe kulluese, mure mbrojtëse	3,500,000
Totali	2025–2031			17,500,000




Figura 6. Grafiku i afateve kohore të investimeve sipas fazave

6.5 Zonat kryesore të investimeve

Bazuar në analizën e prioriteteve dhe matricën e prioritizimit, janë identifikuar pesë zona kryesore të investimeve:

Tabela 39. Zonat kryesore të investimeve dhe përshkrimi i tyre

Zona	Ndërhyrjet e planifikuara	Përfituesit	Kosto (€)
Qyteti i Rahovecit	WWTP urban, kolektorët kryesorë, rehabilitimi i rrjetit, kanale atmosferike, ndarja fekale/atmosferike	~16,000 banorë + biznese dhe institucione	7,000,000
Krushë e Madhe dhe rrethinë	WWTP rural, kolektorë, rrjet i ri kanalizimi	~6,000 banorë	3,500,000
Gexhë dhe rrethinë	WWTP rural, kolektorë, rrjet i ri kanalizimi	~4,000 banorë	3,500,000
Zonat e rrezikuara nga vërshimet	Mure mbrojtëse, kanale kulluese, sisteme drenazhimi	Fortesë, Xërxë, Celinë, Çifllak, Dejnë, etj.	2,700,000
Zona industriale	Sisteme të dedikuara për paratrajtim dhe shkarkime industriale	~50 operatorë ekonomikë	800,000

6.6 Investimet e planifikuara me buxhetin e Kosovës deri në vitin 2026

Sipas Buxhetit të Kosovës dhe planifikimeve lokale, Komuna e Rahovecit ka parashikuar investime në infrastrukturën publike që lidhen me sektorin e ujërave:

Nga Granti Qeveritar (deri në 2025): 7,354,618 €

Nga të hyrat vetanake (2025): 1,162,444 €

Investimet specifike në infrastrukturën e ujërave përfshijnë:

- Rregullimi i shtretërve të lumenjve (Hoçë e Madhe, Brestoc, Nagavc, Krushë e Madhe): 370,556 €
- Përmirësimi i kanalizimeve (Pastaselë dhe vendbanime të tjera): 421,573 €
- Ndërtimi dhe rregullimi i kanalizimeve fekale: 375,000 €
- Ndërtimi dhe trajtimi i ujërave atmosferike në qytet: 330,000 €

7. KOORDINIMI DHE QEVERISJA

7.1 Parimet e koordinimit

Koordinimi dhe qeverisja e qëndrueshme janë thelbësore për zbatimin efektiv të strategjisë për menaxhimin e ujërave të zeza. Ky proces siguron që të gjitha palët e interesuara, nga institucionet publike deri te komuniteti lokal dhe donatorët ndërkombëtarë, të bashkëpunojnë në mënyrë efektive për arritjen e objektivave strategjike dhe operacionale.

Parimet udhëzuese të koordinimit janë:

- **Qartësia e roleve:** Çdo institucion ka përgjegjësi të qarta dhe të dallueshme, pa mbivendosje të kompetencave
- **Llogaridhënia:** Çdo nivel raporton për progresin dhe problemet sipas një kalendari të përcaktuar
- **Efikasiteti:** Shmangja e dyfishimit të përpjekjeve dhe burimeve përmes koordinimit të rregullt
- **Transparenca:** Informacioni është i aksesueshëm për të gjithë aktorët dhe publikun

7.2 Struktura institucionale dhe organogrami

Struktura institucionale për zbatimin e strategjisë përfshin katër nivele: nivelin kombëtar (politikëbërës), nivelin rajonal (koordinues), nivelin lokal (zbatues) dhe nivelin operacional (ofrues i shërbimeve). Secili nivel ka role dhe përgjegjësi të qarta që sigurojnë një zinxhir të plotë të vendimmarrjes dhe llogaridhënies.




Figura 7. Organogrami i koordinimit institucional për zbatimin e strategjisë

7.3 Rolet, vendimmarrja dhe raportimi sipas institucioneve

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të detajuar rolin, kompetencat e vendimmarrjes dhe detyrimet e raportimit për secilën institucion të përfshirë në zbatimin e strategjisë.

Tabela 40. Institucionet, rolet, vendimmarrja dhe raportimi

Institucioni	Roli kryesor	Vendimmarrja	Raportimi
MMPHI (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës)	Hartimi i politikave kombëtare për sektorin e ujërave; harmonizimi me direktivat e BE-së; mbështetja financiare nga buxheti qendror; mbikëqyrja e përputhshmërisë së komunave me standardet	Miratimi i strategjive dhe planeve kombëtare; alokimi i fondeve nga buxheti qendror; miratimi i standardeve teknike dhe normave të shkarkimit	Raporton vjetore te Qeveria e Kosovës; raporton periodikisht te Kuvendi i Kosovës për gjendjen e sektorit
AMMK (Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës)	Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore; inspektimi i shkarkimeve; lëshimi i lejeve mjedisore; zbatimi i masave ndëshkuese ndaj shkelësve	Lëshimi, refuzimi ose revokimi i lejeve mjedisore për shkarkime; vendosja e gjobave dhe masave korrigjuese për shkelësit	Publikon raportin vjetor për gjendjen e mjedisit; raporton te MMPHI për inspektimet dhe lejet e lëshuara
ARRU (Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit)	Rregullimi ekonomik i ofruesve të shërbimeve të ujit; miratimi i tarifave; monitorimi i performancës së kompanive rajonale të ujësjellësit	Miratimi i tarifave të propozuara nga KRU; vendosja e standardeve të performancës; miratimi i planeve të biznesit të KRU-ve	Publikon raportin vjetor të performancës së KRU-ve; raporton te Kuvendi i Kosovës
ARPL (Autoriteti i Pellgut Lumor të Drinit) (sipas Ligjit për Ujërat dhe strukturës institucionale në fuqi)	Menaxhimi i integruar i pellgut lumor; koordinimi rajonal mes komunave të pellgut; planifikimi i burimeve ujore në nivel pellgu	Vendime për shpërndarjen e burimeve ujore në nivel pellgu; koordinimi i masave të përbashkëta për mbrojtjen e pellgut; miratimi i planeve të pellgut	Raporton vjetore te MMPHI; koordinon me komunat e pellgut
Komuna e Rahovecit (Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Urbanizem,	Planifikimi strategjik lokal; koordinimi i zbatimit të strategjisë; mbikëqyrja e projekteve kapitale; bashkëfinancimi; prokurimi i punëve; ndërlidhja me komunitetin	Miratimi i projekteve lokale në Kuvendin Komunal; buxhetimi vjetor; nënshkrimi i kontratave të prokurimit; vendime për prioritetet lokale të investimeve	Raporton tremujore te Kryetari i Komunës; raporton vjetore te Kuvendi Komunal; raporton vjetore te MMPHI
KRU "Gjakova"	Operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit dhe impianteve të trajtimit; mbledhja e tarifave nga përdoruesit; menaxhimi teknik i sistemeve; raportimi i të dhënave operative	Vendime operative për funksionimin e sistemeve; propozime për tarifa (miraton ARRU); vendime për mirëmbajtjen preventive dhe korrigjuese	Raporton mujore/tremujore te Komuna për çështjet operative; raporton vjetore te ARRU dhe MMPHI
Donatorët ndërkombëtarë (BE/IPA, KfW, BERZH)	Financimi i projekteve kapitale; asistenca teknike; mbikëqyrja e projekteve të financuara; ngritja e kapaciteteve të institucioneve lokale	Miratimi i financimeve sipas kriterëve të programeve; miratimi i ndryshimeve në projekte; vlerësimi i performancës së zbatimit	Raporte të projekteve sipas marrëveshjeve të financimit (zakonisht gjashtëmujore ose vjetore)

7.4 Grupi Punues Komunal për Ujërat

Për të siguruar koordinim efektiv në nivel lokal dhe për të krijuar një mekanizëm të qëndrueshëm për ndjekjen e zbatimit të strategjisë, krijohet Grupi Punues Komunal për Ujërat. Ky grup do të shërbejë si organ koordinues ndërmjet drejtorive të komunës dhe KRU-së, duke siguruar që të gjitha aktivitetet të jenë të harmonizuara dhe problemet të adresohen në kohë.

Tabela 41. Struktura dhe funksionimi i Grupit Punues Komunal

Elementi	Përshkrimi
Themelimi	Vendim i Kryetarit të Komunës, brenda 3 muajve nga miratimi i strategjisë
Përbërja	Drejtori i Shërbimeve Publike; Drejtori i Mjedisit; Përfaqësues i KRU "Gjakova" (nivel menaxherial); Përfaqësues i Drejtorisë së Financave; Përfaqësues i NJPZ (Njësia për Mbrojtje dhe Shpëtim); Përfaqësues i sektorit të bujqësisë (sipas nevojës, për çështje të ujitjes dhe ndotjes bujqësore)
Takimet	Çdo 2 muaj (6 takime/vit), ose më shpesh në raste emergjente (vërshime, probleme kritike në projekte)
Sekretariati	Drejtorja e Shërbimeve Publike siguron sekretariatit teknik (përgatitja e agjendës, ftesave, procesverbaleve, ndjekja e zbatimit të vendimeve)
Detyrat kryesore	1) Koordinimi i zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit; 2) Monitorimi i progresit ndaj objektivave dhe indikatorëve; 3) Identifikimi dhe zgjidhja e problemeve operacionale; 4) Përgatitja e raporteve të progresit për Kuvendin Komunal; 5) Koordinimi me nivelin qendror dhe donatorët
Vendimmarja	Rekomanduese; vendimet formale merren nga Kryetari ose Kuvendi Komunal sipas kompetencave ligjore. Rekomandimet e Grupit Punues formalizohen me procesverbal të nënshkruar nga anëtarët dhe shkresë përcjellëse drejtuar Kryetarit të Komunës.
Raportimi	Raporton pas çdo takimi te Kryetari i Komunës; përgatit raportin tremujor të progresit

7.5 Mekanizmat e koordinimit vertikal dhe horizontal

Zbatimi efektiv i strategjisë kërkon koordinim të vazhdueshëm si në drejtim vertikal (me nivelin qendror) ashtu edhe në drejtim horizontal (me komunat fqinje dhe aktorët lokalë).

Tabela 42. Mekanizmat e koordinimit vertikal (me nivelin qendror)

Mekanizmi	Frekuenca	Pjesëmarrësit	Qëllimi
Takime koordinimi me MMPHI	Çdo 6 muaj	Komuna (Drejtori i Infrastrukturës), MMPHI, KRU	Harmonizimi i politikave, informim për financimet e disponueshme, raportimi i progresit
Koordinimi me AMMK	Sipas nevojës (të paktën 2/vit)	Komuna (Drejtorja e Mjedisit), AMMK	Lejet mjedisore, inspektimet, monitorimi i cilësisë së ujërave
Koordinimi me ARRU	Vjetore	KRU "Gjakova", ARRU, Komuna	Tarifat, standardet e performancës, planet e biznesit
Koordinimi me donatorët	Sipas ciklit të projektit	Komuna, donatorët, MMPHI	Zbatimi i projekteve, raportimi, disbursimi i fondeve

Tabela 43. Mekanizmat e koordinimit horizontal (me komunat fqinje dhe aktorët lokalë)

Mekanizmi	Frekuenca	Pjesëmarrësit	Qëllimi
Koordinimi në nivel pellgu (ARPL)	Vjetore (ose sipas nevojës)	Komunat e pellgut të Drinit (Rahovec, Gjakovë, Prizren, Malishevë, etj.), ARPL	Menaxhimi i integruar i pellgut, masat e përbashkëta për mbrojtjen e ujërave
Bashkëpunimi operacional me KRU "Gjakova"	Mujore/tremujore	Komuna (Drejtoria e Sherbimeve Publike), KRU	Çështjet operative, planet e investimeve, tarifat, mirëmbajtja
Konsultimet me komunitetin	≥12 takime/vit	Komuna, banorët e fshatrave, OJQ lokale	Identifikimi i nevojave lokale, trajtimi i ankesave, informimi për projektet
Bashkëpunimi me bizneset	≥2/vit	Komuna, AMMK, operatorët industrialë	Kërkesat për shkarkime, paratrajtimi, marrëveshjet e bashkëpunimit

7.6 Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit

Monitorimi dhe raportimi i rregullt janë thelbësorë për të siguruar që strategjia po zbatohet sipas planit dhe për të mundësuar korrigjime në kohë kur identifikohen probleme ose vonesa.

Tabela 44. Struktura e raportimit për zbatimin e strategjisë

Niveli	Lloji i raportit	Përgjegjësi	Frekuenca	Marrësit	Përmbajtja kryesore
Operacional	Raport teknik operacional	KRU "Gjakova"	Mujore	Grupi Punues Komunal	Të dhëna teknike (prurje të trajtuara, cilësi e shkarkimeve, defekte), statusi i mirëmbajtjes, mbledhja e tarifave
Lokal	Raport i progresit të strategjisë	Grupi Punues (përmes Drejtorisë së (Sherbimeve Publike)	Tremujore	Kryetari i Komunës, Kuvendi Komunal	Progresi ndaj objektivave, shpenzimet, problemet e identifikuar, rekomandimet
Lokal	Raport vjetor i strategjisë	Komuna (Drejtoria e (Sherbimeve Publike)	Vjetore (dhjetor)	Kuvendi Komunal, MMPHI, AMMK	Arritjet vjetore, vlerat e indikatorëve, pasqyra financiare, planet për vitin e ardhshëm
Publik	Informimi i publikut	Komuna (Zyra për Informim)	Vjetore	Qytetarët, media	Publikimi në faqen zyrtare të komunës, prezantimi publik, broshura informuese
Kombëtar	Raport për MMPHI	Komuna	Vjetore	MMPHI	Përputhshmëria me strategjinë kombëtare, nevojat për mbështetje financiare dhe teknike

Tabela 45. Indikatorët e koordinimit dhe qeverisjes

Indikatori	Njësia	Frekuenca e matjes	Targeti
Takimet e Grupit Punues të mbajtura	Numër/vit	Vjetore	≥6
Procesverbalet e takimeve të dokumentuara dhe arkivuara	% e takimeve	Vjetore	100%
Raportet tremujore të dorëzuara në afat	Numër/vit	Vjetore	4
Takimet me MMPHI të realizuara	Numër/vit	Vjetore	≥2
Vendimet e Kuvendit Komunal për sektorin e ujërave	Numër/vit	Vjetore	Sipas nevojës (≥2)
Marrëveshjet me donatorë të nënshkruara	Numër (kumulative)	Kumulative	Sipas mundësive të financimit
Ankesat e qytetarëve të trajtuara brenda afatit (15 ditë)	% e ankesave	Vjetore	≥90%

7.6.1 Adresa e qartë për zbatimin, monitorimin dhe raportimin

Pas miratimit të Strategjisë, Komuna e Rahovecit cakton një adresë të qartë për përgjegjësitë e zbatimit, monitorimit dhe raportimit, duke siguruar koordinim ndërmjet sektorëve dhe institucioneve të përfshira. Ky mekanizëm përfshin:

- Njësinë Koordinuese për Ujërat e Zeza (brenda Drejtorisë përkatëse), e cila mbikëqyr zbatimin e masave, koordinon mbledhjen e të dhënave dhe përgatit raportet periodike;
- Përcaktimin dhe mirëmbajtjen e TKP/KPI për matje objektive të progresit (Tabela 57/Tabela e TKP);
- Raportim të rregullt dhe transparent, ku raportet e progresit shërbejnë si instrument pune për përmirësim dhe për informim të vendimmarrjes.

7.7 Ngritja e kapaciteteve

Zbatimi i suksesshëm i strategjisë kërkon kapacitete adekuate teknike dhe menaxheriale në të gjitha nivelet. Për këtë qëllim, parashihen këto masa për ngritjen e kapaciteteve:

Në nivel komunal:

- Trajnime për stafin e Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Mjedisit në menaxhimin e projekteve, prokurimin publik dhe monitorimin mjedisor
- Rishikimi i strukturës organizative për të siguruar burime njerëzore të mjaftueshme për koordinimin e strategjisë
- Përmirësimi i sistemeve të menaxhimit të informacionit për ndjekjen e progresit

Në nivel të KRU-së:

- Trajnime teknike për operimin dhe mirëmbajtjen e impianteve të trajtimit
- Ngritja e kapaciteteve për matjen e cilësisë së ujërave dhe raportimin
- Përmirësimi i sistemit të faturimit dhe mbledhjes së tarifave

Bashkëpunimi me donatorët:

- Shfrytëzimi i programeve të asistencës teknike për trajnime dhe shkëmbim përvojash
- Pjesëmarrja në rrjete profesionale rajonale dhe ndërkombëtare

8. PJESËMARRJA PUBLIKE DHE KOMUNIKIMI

8.1 Rëndësia e pjesëmarrjes publike

Pjesëmarrja publike dhe komunikimi janë elemente thelbësore në menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave të zeza. Angazhimi aktiv i qytetarëve ndihmon në rritjen e transparencës, forcimin e besimit ndër-institucional dhe krijimin e një kulture bashkëpunimi që ndikon drejtpërdrejt në suksesin e strategjisë.

Qëllimet kryesore të pjesëmarrjes publike janë:

- Sigurimi i mbështetjes së komunitetit për projektet infrastrukturore
- Rritja e vetëdijes për rëndësinë e trajtimit të ujërave të zeza
- Inkurajimi i raportimit të problemeve nga qytetarët
- Përmirësimi i shkallës së mbledhjes së tarifave përmes ndërgjegjësimit

8.2 Mekanizmat e pjesëmarrjes publike

Tabela 46. Mekanizmat e pjesëmarrjes publike dhe menaxhimi i tyre

Mekanizmi	Përshkrimi	Frekuenca	Përgjegjësi	Dokumentimi
Konsultime publike	Dëgjime publike para miratimit të projekteve të mëdha infrastrukturore; prezantimi i planeve dhe marrja e komenteve	Para çdo projekti madhor (≥500,000 €)	Komuna (Drejtoria e Infrastrukturës)	Procesverbale, lista e pjesëmarrësve, komentet e marra, përgjigjet
Takime me komunitete	Takime në fshatra për identifikimin e nevojave dhe prioritetëve lokale; diskutimi i problemeve specifike	≥12 takime/vit (≥1/muaj)	Komuna, KRU	Raporti i takimit, lista e çështjeve të ngritura
Kutia e ankesave	Ankesa dhe sugjerime me shkrim nga qytetarët në sportelet e Komunës dhe KRU	I vazhdueshëm	Komuna (Qendra për Shërbim të Qytetarëve)	Regjistri i ankesave, afatet e përgjigjes
Linja telefonike	Numër telefoni për raportimin e problemeve urgjente (bllokime, rrjedhje, ndotje)	I vazhdueshëm (24/7 për emergjencat)	KRU "Gjakova"	Regjistri i thirrjeve, koha e reagimit
Platforma online	Formular online në faqen e Komunës për raportimin e problemeve dhe marrjen e informacionit	I vazhdueshëm	Komuna	Sistemi elektronik i menaxhimit të ankesave
Takime me bizneset	Konsultime me operatorët industrialë për kërkesat e shkarkimeve dhe paratrajtimin	≥2/vit	Komuna, AMMK	Procesverbale, marrëveshje

8.3 Fushatat e ndërgjegjësimit publik

Fushatat e ndërgjegjësimit kanë për qëllim të rrisin informimin dhe edukimin e qytetarëve mbi sfidat dhe mundësitë e menaxhimit të ujërave të zeza, si dhe të promovojnë sjellje të përgjegjshme.

Tabela 47. Plani i fushatave ndërgjegjësuere 2025–2031

Fushata	Qëllimi	Grupi i synuar	Mesazhet kryesore	Afati	Përgjegjësi
"Ruaj ujin, ruaj jetën"	Edukimi për mbrojtjen e burimeve ujore	Nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme	Uji është burim i kufizuar; mos e ndot; kujdesu për të	2025–2026	Komuna (DKA), OJQ lokale
"Mos e ndot lumen"	Parandalimi i hedhjes së mbeturinave në lumenj	Banorët e fshatrave përgjatë lumenjve	Mbeturinat në lum kthehen te ti; respekto mjedisin	2026–2027	Komuna, OJQ mjedisore
"Trajtimi i ujit – shëndeti yt"	Informimi mbi rreziqet shëndetësore nga uji i ndotur	Publiku i gjerë, veçanërisht zonat rurale	Uji i patrajtuar shkakton sëmundje; impiantet na mbrojnë	2027–2028	Komuna, Qendra e Shëndetit
"Raporto ndotjen"	Nxitja e raportimit të problemeve nga qytetarët	Publiku i gjerë	Nëse sheh ndotje, raporto; bashkë e mbrojmë mjedisin	2028–2029	Komuna, KRU
"Paguaj tarifën, mbështet komunitetin"	Rritja e shkallës së mbledhjes së tarifave	Përdoruesit e shërbimeve të KRU	Tarifa financon mirëmbajtjen; mospagesa dëmton të gjithë	2029–2031	KRU "Gjakova"

8.4 Kanalet e komunikimit

Kanalet tradicionale:

- Takime publike dhe forume komunitare në salla të fshatrave
- Broshura dhe postera informues të shpërndarë në institucione publike
- Mediat lokale (radio, TV lokale, gazeta)
- Njoftimet në tabela të informimit nëpër fshatra

Kanalet dixhitale:

- Faqja zyrtare e Komunës së Rahovecit (seksioni për ujërat dhe mjedisin)
- Rrjetet sociale (Facebook, Instagram) për njoftime dhe fushata
- Aplikacioni për raportim të problemeve (propozim për zhvillim në Fazën II)

8.5 Trajtimi i ankesave dhe kërkesave

Për të siguruar që ankesat dhe kërkesat e qytetarëve trajtohen në mënyrë efikase, do të zbatohet një procedurë e standardizuar:

Procedura e trajtimit të ankesave:

1. **Pranimi:** Ankesa regjistrohet në regjistrin e ankesave (fizik ose elektronik) brenda 1 dite pune
2. **Klasifikimi:** Ankesa klasifikohet sipas urgjencës dhe llojit (teknik, administrativ, emergjent)
3. **Hetimi:** Institucioni përgjegjës (Komuna ose KRU) heton çështjen brenda 5 ditëve pune
4. **Përgjigja:** Qytetari njoftohet për rezultatin brenda 15 ditëve pune (ose menjëherë për emergjencat)
5. **Ndjekja:** Çështjet e pazgjidhura ndiqen deri në zgjidhje dhe dokumentohen

9. PROJEKSIONET FINANCIARE DHE ZBUTJA E RREZIQEVE

9.1 Projektionet e detajuara financiare

9.1.1 Kostoja kapitale

Kostoja kapitale totale e parashikuar për zbatimin e strategjisë është 17,500,000 €, e shpërndarë sipas komponentëve të infrastrukturës.

Tabela 48. Kostoja kapitale sipas komponentëve

Komponenti	Kosto (€)	Përqindja
WWTP kryesor urban (Rahovec)	3,500,000	20.0%
2 WWTP rurale (Krushë e Madhe, Gexhë)	4,600,000	26.3%
Kolektorët kryesorë (urban + rural)	3,400,000	19.4%
Rehabilitimi i rrjetit ekzistues	2,500,000	14.3%
Kanale atmosferike dhe kulluese	1,500,000	8.6%
Mure mbrojtëse kundër vërshimeve	1,200,000	6.9%
Studime teknike, mbikëqyrje, kontingjencë	800,000	4.5%
Totali kapital	17,500,000	100%

9.1.2 Kostoja operative vjetore

Pas përfundimit të infrastrukturës, operimi i impianteve dhe mirëmbajtja e sistemit do të kenë kosto vjetore të parashikuara si më poshtë:

Tabela 49. Kostoja operative vjetore e parashikuar (pas 2030)

Kategoria	Kosto vjetore (€)	Përqindja
Personeli dhe trajnimi	250,000	47.6%
Energjia elektrike	150,000	28.6%
Materiale të konsumueshme dhe reagentë	75,000	14.3%

Mirëmbajtja preventive dhe korrigjuese	50,000	9.5%
Totali operativ/vit	525,000	100%

9.1.3 Projektionet financiare afatgjata (2025–2035)

Tabela 50. Projektionet financiare 10-vjeçare

Viti	Shpenzimet kapitale (€)	Shpenzimet operative (€)	Totali (€)
2025	3,000,000	100,000	3,100,000
2026	4,000,000	200,000	4,200,000
2027	1,500,000	350,000	1,850,000
2028	2,750,000	400,000	3,150,000
2029	2,750,000	450,000	3,200,000
2030	1,750,000	500,000	2,250,000
2031	1,750,000	525,000	2,275,000
2032	-	525,000	525,000
2033	-	525,000	525,000
2034	-	525,000	525,000
2035	-	525,000	525,000
Totali	17,500,000	4,625,000	22,125,000

Përmbledhje e investimeve të planifikuara nga KRU (PLANI AFATGJATË I INVESTIMEVE 2019 – 2028)

Tabela 51. Përmbledhje e investimeve të planifikuara (PAI 2019–2028)

Kategoria	Nën-kategoria	Vlera (EUR)
Ujësjellës	Gjithsej ujësjellës	49,859,984
Kanalizim	Zgjerimi i rrjetit	900,000
Kanalizim	Rehabilitimi i rrjetit	13,536,666
Kanalizim	ITUN + kolektorët 1&2	12,817,045
Gjithsej kanalizim		27,253,711
Gjithsej investime		77,113,695

PAI 2019–2028 i KRU “Gjakova” e ndan dinamikën e investimeve në kanalizim në dy periudha (2019–2023 dhe 2024–2028) dhe parashikon ndërhyrje të shpërndara në gjithë zonën e shërbimit, përfshirë edhe zgjerimin e rrjetit të kanalizimit në Komunën e Rahovecit dhe ndërhyrje specifike si rivendosja e gypave të kanalizimit në Rahovec. Strategjia e Komunës së Rahovecit duhet të harmonizohet me këtë dinamikë, sidomos për: (i) projektimin e kolektorëve/impianeteve, (ii) rehabilitimin e segmenteve kritike, dhe (iii) ndarjen fekale/atmosferike në zonat ku ka mbingarkesa gjatë reshjeve.

PAI vlerëson se pjesa dërrmuese e investimeve kërkon financim të jashtëm (grante/qeveri/donatorë), ndërsa një pjesë më e vogël mbulohet nga të hyrat vetanake të KRU (të lidhura me proceset tarifore dhe performancën e arkëtimit). Kjo e bën të domosdoshëm planifikimin e bashkëfinancimit komunal dhe përgatitjen e projekteve “bankable” për aplikim te donatorët.

9.2 Burimet e financimit

Strategjia parasheh një kombinim të burimeve të financimit për të siguruar realizimin e investimeve të planifikuara.

Tabela 52. Burimet e financimit dhe kontributi i parashikuar

Burimi	Kontributi (€)	Përqindja	Statusi
Grante ndërkombëtare (BE/IPA, KfW, BERZH)	7,000,000	40%	Për t'u aplikuar/siguruar
Partneritete publiko-private (PPP)	5,250,000	30%	Për t'u eksploruar
Kontribute lokale dhe tarifa	3,500,000	20%	Të planifikuara
Buxheti qendror dhe lokal	1,750,000	10%	Pjesërisht të siguruara
Totali	17,500,000	100%	

9.2.1 Korniza orientuese për PPP dhe kriteret minimale të aplikimit

Përdorimi i partneriteteve publiko-private (PPP) do të konsiderohet vetëm kur vërtetohet se sjell vlerë të shtuar krahasuar me prokurimin tradicional dhe kur nuk rrezikon përballueshmërinë e tarifave për qytetarët. Para inicimit të çdo modeli PPP do të kryhen këto hapa minimalë:

- Analiza “Value for Money” dhe krahasimi me opsionin publik (Public Sector Comparator), për të dëshmuar përfitimin ekonomik dhe performancën.
- Analiza e përballueshmërisë (affordability) dhe ndikimit në tarifa, me skenarë (bazë/pesimist/optimist) dhe masat mbrojtëse për kategoritë vulnerabël.
- Ndarja e qartë e rreziqeve (ndërtim, operim, performancë, kërkesë, energji) dhe përcaktimi i indikatorëve të performancës që lidhen me pagesat (performance-based payments).
- Struktura e transparencës dhe llogaridhënies: raportim periodik publik, auditim financiar dhe teknik, si dhe mekanizëm ankese për qytetarët.
- Përcaktimi i modelit të preferuar PPP sipas rastit: kontratë O&M, DB(O), ose DBFO/koncesion, varësisht nga kapacitetet institucionale dhe rreziku i projektit.

9.3 Vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut financiar

9.3.1 Identifikimi i rreziqeve financiare

Tabela 53. Rreziqet financiare, probabiliteti dhe ndikimi

Rreziku	Përshkrimi	Probabiliteti	Ndikimi	Niveli i rrezikut
Inflacioni i lartë	Rritja e kostove të materialeve dhe punës mbi parashikimet	Mesatar	I lartë	I lartë
Mungesa/vonesa e granteve	Donatorët nuk miratojnë financimet ose vonojnë disbursimin	Mesatar	I lartë	I lartë
Mbledhje e ulët e tarifave	Qytetarët nuk paguajnë tarifat e shërbimeve, duke krijuar mungesë likuiditeti	Mesatar	Mesatar	Mesatar
Vonesa në zbatim	Prokurimi ose ndërtimi vonohen, duke rritur kostot	Mesatar	Mesatar	Mesatar
Kosto papritura teknike	Probleme gjeologjike ose teknike që kërkojnë ndërhyrje shtesë	I ulët	Mesatar	I ulët

Mungesa e kapaciteteve lokale	Mungesa e stafit teknik për menaxhimin e projekteve	Mesatar	Mesatar	Mesatar
-------------------------------	---	---------	---------	---------

9.3.2 Strategjitë e zbutjes së rreziqeve

Tabela 54.Strategjitë e zbutjes së rreziqeve financiare

Rreziku	Strategjia e zbutjes	Përgjegjësi
Inflacioni i lartë	Përfshirja e kontingjencës 10% në buxhet; rishikimi vjetor i kostove; prioritizimi i fazave sipas fondeve të disponueshme; kontrata me çmime fikse kur është e mundur	Komuna, KRU
Mungesa/vonesa e granteve	Diversifikimi i burimeve të financimit; përgatitja e projekteve për PPP si alternativë; fazimi i projekteve sipas fondeve të siguruar; aplikimi paralel në disa programe	Komuna, MMPHI
Mbledhje e ulët e tarifave	Fushata ndërgjegjësimi; përmirësimi i sistemit të faturimit dhe arkëtimit; masa ligjore për mospaguesit kronikë; subvencione të synuara për shtresat e cënueshme	KRU "Gjakova"
Vonesa në zbatim	Planifikimi i detajuar i prokurimit; monitorimi i rregullt i kontratave; klauzola penalteti në kontrata; identifikimi i hershëm i problemeve	Komuna
Kosto të papritura teknike	Studime paraprake të detajuara; kontingjencë teknike në buxhet; mbikëqyrje e kualifikuar gjatë ndërtimit	Komuna, konsulentët
Mungesa e kapaciteteve lokale	Trajnime për stafin ekzistues; rekrutimi i stafit të ri teknik; kontraktimi i ekspertizës së jashtme kur nevojitet	Komuna, KRU

9.3.3 Skenari alternativ (kur mungojnë grantet)

Nëse financimet ndërkombëtare nuk realizohen sipas parashikimeve, propozohet zbatimi i skenarëve alternativë:

Skenari A: Fazimi i zgjeruar

- Shtrirja e zbatimit në 10 vite (deri 2034) në vend të 7 viteve
- Fokusimi në Fazën I (WWTP urban dhe kolektorët kryesorë) me fondet e disponueshme
- Shtyrja e Fazës II dhe III derisa të sigurohen financime shtesë

Skenari B: PPP e zgjeruar

- Rritja e pjesëmarrjes së sektorit privat deri në 50% të financimit
- Kontraktimi i ndërtimit dhe operimit të WWTP-ve përmes modelit BOT (Build-Operate-Transfer)
- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për tërheqjen e investitorëve privatë

Skenari C: Rritja graduale e tarifave

- Rritja e tarifave të shërbimeve me 5–7% në vit për të siguruar financim shtesë
- Përdorimi i të ardhurave shtesë për bashkëfinancim të projekteve dhe mirëmbajtje
- Vendosja e skemave të subvencionimit për familjet me të ardhura të ulëta

10. MENAXHIMI I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET

10.1 Konteksti dhe lidhja me sistemin e kanalizimit

Përmbytjet në Komunën e Rahovecit lidhen drejtpërdrejt me sistemin e kanalizimit dhe menaxhimin e ujërave në përgjithësi. Kjo lidhje manifestohet në disa dimensione:

Mungesa e ndarjes së sistemit fekal nga ai atmosferik: Në shumicën e vendbanimeve, ujërat atmosferike (shiu) dhe ujërat fekale transportohen në të njëjtin rrjet. Gjatë reshjeve intensive, ky sistem mbingarkohet, duke shkaktuar:

- Kthim të ujërave në shtëpi dhe biznese
- Vërshime urbane nga pusetat e kanalizimit
- Ngarkesë të tepruar në impiantet e ardhshme të trajtimit

Bllokimi i kanaleve: Hedhja e mbeturinave në kanale dhe lumenj shkakton ngushtimin e kapacitetit bartës dhe rrit rrezikun e vërshimeve.

Mungesa e kanaleve kulluese: Zonat e ulëta nuk kanë sisteme adekuate drenazhimi, duke krijuar grumbullim të ujërave sipërfaqësore.

Strategjia e menaxhimit të ujërave të zeza duhet të integrojë masat kundër përmbytjeve si komponent thelbësor, duke siguruar që investimet në infrastrukturë të jenë të mbrojtura dhe funksionale.

10.2 Zonat e rrezikuara dhe masat e propozuara

Bazuar në analizën e vërshimeve të kaluara dhe karakteristikave gjeografike, janë identifikuar zonat më të rrezikuara dhe masat specifike për secilën.

Tabela 55. Zonat e rrezikuara, masat, prioriteti dhe kostoja

Zona	Shkaku kryesor i rrezikut	Masa e propozuar	Prioriteti	Kosto (€)
Fortesë (Bellacërkë)	Afërsia me lumin, mungesë digash mbrojtëse	Mur mbrojtës, kanal kullues, pastrim i shtratit	I lartë	400,000
Xërxë	Terren i ulët, bllokime të shpeshta të kanaleve	Kanal atmosferik i ri, pastrim dhe zgjerim i shtratit të lumit	I lartë	350,000
Krushë e Madhe	Prurje nga zonat malore, ngushtim i shtratit	Zgjerimi i shtratit, mur mbrojtës, sistem drenazhimi	I lartë	450,000
Celinë	Afërsia me Drinin e Bardhë, terren i ulët	Digë mbrojtëse, kanal devijues	Mesatar	300,000
Çifllak	Mungesë kanalizimi atmosferik, sistem i përzier	Kanale atmosferike të ndarë nga sistemi fekal	Mesatar	200,000
Rahovec (Nënqyteti)	Mbingarkesë e sistemit të kanalizimit, terren i ulët	Ndarja fekale/atmosferike, pompa shtesë	I lartë	500,000
Dejnë	Terren i ulët, mungesë drenazhimi	Kanale kulluese, sistem grumbullimi	Mesatar	150,000
Ratkoc	Afërsia me përroskën, sedimente	Pastrim i shtratit, mure në pikat kritike	Mesatar	150,000
Gexhë, Radostë	Afërsia me përrenj, terren i pjerrët	Pastrim shtrati, mure të vogla mbrojtëse	Mesatar	200,000
Totali				2,700,000

10.3 Masat parandaluese

10.3.1 Masat strukturore

Masat strukturore përfshijnë ndërhyrje fizike në infrastrukturë dhe terren për të reduktuar rrezikun e vërshimeve.

Tabela 56. Masat strukturore parandaluese

Masa	Përshkrimi	Efekti i pritur	Afati
Ndërtimi i mureve mbrojtëse	Mure betoni ose guri përgjatë lumenjve në zonat kritike, me lartësi dhe gjatësi sipas analizës hidraulike	Reduktimi i vërshimeve me 60–70% në zonat e mbrojtura	2026–2028
Zgjerimi i shtretërve të lumenjve	Heqja e pengesave, pastrimi i sedimenteve, zgjerimi i kapacitetit bartës	Rritja e kapacitetit bartës me 30–50%	2025–2027
Kanale kulluese dhe drenazhimi	Kanale për devijimin e ujërave nga zonat e banuara drejt trupave ujorë	Drenazhimi i zonave të ulëta, reduktimi i kohës së grumbullimit	2027–2029
Ndarja fekale/atmosferike	Ndërtimi i kanaleve të veçanta për ujërat atmosferike	Reduktimi i mbingarkesës së sistemit fekal me 40–60%	2028–2030
Rezervuarë të përkohshëm	Hapësira për grumbullimin e përkohshëm të ujërave gjatë reshjeve intensive	Vonesa e pikut të prurjeve, mbrojtja e zonave të poshtme	2029–2031

10.3.2 Masat jostrukturore

Masat jostrukturore përfshijnë veprime administrative, edukative dhe organizative që nuk kërkojnë ndërhyrje të mëdha fizike.

Tabela 57. Masat jostrukturore parandaluese

Masa	Përshkrimi	Përgjegjësi
Hartëzimi i zonave të rrezikuara	Përgatitja e hartave të detajuara të rrezikut për përdorim në planifikim urban dhe reagim emergjent	Komuna, IHMK
Sistemi i paralajmërimit të hershëm	Vendosja e sensorëve për monitorimin e nivelit të ujit dhe sistemit të njoftimeve	Komuna, IHMK, NJPZ
Ndalimi i ndërtimeve në zonat e rrezikuara	Zbatimi i rreptë i planit hapësinor për të parandaluar ndërtimet në zonat e përmbytura	Komuna (Urbanizmi)
Edukimi i komunitetit	Fushata për gatishmërinë ndaj emergjencave dhe sjelljen gjatë vërshimeve	NJPZ, Komuna
Plani i reagimit emergjent	Përditësimi i planit komunal për reagim ndaj vërshimeve	NJPZ, Komuna

10.4 Sistemi i paralajmërimit të hershëm (propozim)

Një sistem efektiv i paralajmërimit të hershëm mund të shpëtojë jetë dhe të zvogëlojë ndjeshëm dëmet materiale duke siguruar kohë të mjaftueshme për evakuim dhe marrjen e masave mbrojtëse.

Tabela 58. Komponentët e sistemit të paralajmërimit të hershëm

Komponenti	Përshkrimi	Përgjegjësi	Afati
Sensorë për nivelin e ujit	Instalimi në 5 pika kritike përgjatë Drinit të Bardhë dhe degëve (Fortesë, Xërxë, Krushë e Madhe, Gexhë, Rahovec)	IHMK, Komuna	2026–2027
Stacioni meteorologjik lokal	Monitorimi i reshjeve në kohë reale për parashikim të prurjeve	IHMK	2026
Platforma e njoftimeve	Sistem SMS dhe njoftime online për banorët e zonave të rrezikuara	Komuna, NJPZ	2027
Protokolli evakuimit	Procedura të qarta për evakuim, vendstrehime, dhe koordinim	NJPZ, Komuna	2026
Trajnimi i komunitetit	Ushtrime periodike për gatishmërinë e banorëve	NJPZ	2026–2031

10.5 Plani për reduktimin e rrezikut nga përmbytjet

Tabela 59. Plani i veprimit për reduktimin e rrezikut nga përmbytjet

Hapi	Aktiviteti	Afati	Përgjegjësi	Indikatori
1	Hartëzimi i detajuar i zonave të rrezikuara dhe pikave kritike	2025	Komuna, IHMK	Harta e plotë e miratuar
2	Përgatitja e projekteve teknike për mure mbrojtëse në zonat prioritare	2025	Komuna	≥3 projekte të gatshme
3	Instalimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm (faza e parë)	2026	Komuna, IHMK	≥3 sensorë të instaluar
4	Ndërtimi i mureve mbrojtëse në zonat me prioritet të lartë	2026–2027	Komuna, kontraktori	≥1,000 m të ndërtuar
5	Ndërtimi i kanaleve atmosferike dhe kulluese	2027–2029	Komuna, KRU	≥5 km kanale
6	Ndarja progresive e sistemit fekal nga ai atmosferik	2028–2030	Komuna, KRU	≥3 zona të ndarë
7	Trajnimi i komuniteteve për gatishmëri ndaj emergjencave	2025–2030	NJPZ, Komuna	≥10 ushtrime
8	Monitorimi dhe vlerësimi i efektivitetit të masave	2027–2030	Komuna	Raporte vjetore




Figura 8. Harta e zonave me rrezik të lartë nga përmbytjet në Komunën e Rahovecit

11. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PERFORMANCËS

11.1 Qëllimi i monitorimit

Monitorimi dhe vlerësimi i performancës së sistemit të menaxhimit të ujërave të zeza është thelbësor për garantimin e një qasjeje të qëndrueshme dhe efikase. Ky proces mundëson:

- Matjen e progresit ndaj objektivave strategjike
- Identifikimin e hershëm të problemeve dhe devijimeve
- Informimin e vendimmarrjes për rialokimin e burimeve
- Sigurimin e llogaridhënies ndaj qytetarëve dhe donatorëve
- Përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve dhe proceseve

11.2 Treguesit kryesorë të performancës (TKP)

Treguesit kryesorë janë zgjedhur duke u bazuar në standardet kombëtare, direktivat e BE-së dhe praktikën më të mirë ndërkombëtare. Ata përfaqësojnë matje sasiore dhe cilësore të rezultateve të arritura.

Tabela 60. Treguesit kryesorë të performancës

Kategoria	Treguesi	Njësia	Vlera bazë (viti i fundit i disponueshëm)	Targeti (2031)	Frekuenca e matjes
Trajtimi ujërave	i Përqindja e popullsisë me qasje në trajtim	%	<5%	≥80%	Vjetore
Trajtimi ujërave	i Cilësia e ujërave të trajtuara (BOD5)	mg/L	do të matet pas startimit të WWTP	≤25	Mujore
Trajtimi ujërave	i Cilësia e ujërave të trajtuara (COD)	mg/L	do të matet pas startimit të WWTP	≤125	Mujore
Trajtimi ujërave	i Cilësia e ujërave të trajtuara (TSS)	mg/L	do të matet pas startimit të WWTP	≤35	Mujore
Infrastruktura	Km rrjet kanalizimi i rehabilituar	km	0	≥15	Vjetore
Infrastruktura	Numri i impianteve funksionale	numër	1 (Kramovik)	4	Vjetore
Infrastruktura	Km kolektorë të ndërtuar	km	0		Vjetore
Financat	Shkalla e mbledhjes së tarifave	%	65–70% (KRU Gjakova)	≥97%	Vjetore
Financat	Investimet kapitale të realizuara	€	11,005,500 € (2023, KRU “Gjakova” – investime kapitale të raportuara; pa	17,500,000	Vjetore (bazuar në raportet financiare vjetore / raportet e

			përfshirë investimet më të vogla pa vlerë të deklaruar)		investime ve)
Mjedisi	Reduktimi i shkarkimeve të patrajtuar	%	0%	≥80%	Vjetore
Mjedisi	Cilësia e ujit në Drinin e Bardhë (BOD5)	mg/L	22.75 (2019, VMV max në pellgun e Drinit të Bardhë AMMK)	Përmirësim	Vjetore
Vërshimet	Dëmet materiale nga vërshimet	€/vit	3,546,477.66 (viti 2022)	Reduktim ≥50%	Vjetore
Komuniteti	Numri i ankesave të trajtuara	% e totalit	100%	100%	Vjetore
Komuniteti	Kënaqshmëria e qytetarëve me shërbimet	%	98.03%	≥70%	Vjetore

Shënim: Vlera bazë për "Investimet kapitale të realizuara" për vitin 2023 është llogaritur nga investimet me vlerë të deklaruar në rezymenë vjetore të KRU "Gjakova"; shuma nuk përfshin investimet e tjera të përmendura pa vlerë monetare ("investime më të cekëta"), prandaj trajtohet si minimum i raportuar.

11.2.1 Burimet e të dhënave dhe metodologjia e matjes së TKP

Për të garantuar krahasueshmëri dhe integritet të të dhënave, për secilin TKP përcaktohen burimi zyrtar i të dhënave, institucioni përgjegjës për raportim dhe metoda e matjes. Të dhënat financiare dhe operative do të merren nga raportet vjetore të KRU "Gjakova" dhe nga raportimet e Komunës, ndërsa të dhënat e cilësisë së ujit do të bazohen në monitorimet laboratorike sipas standardeve relevante dhe në të dhënat e AMMK.

Për indikatorët ku "Vlera bazë" është shënuar si TBD, gjatë vitit të parë të zbatimit do të realizohet matja bazë (baseline) përmes: (i) auditimit teknik të gjendjes së rrjeteve, (ii) verifikimit të të dhënave financiare dhe të arkëtimit, (iii) planit të monitorimit laboratorik, dhe (iv) anketës së kënaqshmërisë së qytetarëve me instrument të standardizuar. Rezultatet e baseline do të miratohen nga Grupi Punues Komunal për Ujërat dhe do të shërbejnë si referencë për targetet vjetore.

11.3 Orari i rishikimeve

Rishikimi i performancës do të kryhet sipas një orari të strukturuar që garanton ndjekjen e vazhdueshme të progresit dhe mundëson korrigjime në kohë.

Tabela 61.Orari i rishikimeve strategjike

Lloji i rishikimit	Frekuenca	Afati	Fokusi	Rezultati i pritur
Rishikimi operacional	Tremujor	Mars, Qershor,	Progresi teknik, shpenzimet, problemet operative	Raport i shkurtër për Grupin Punues

		Shtator, Dhjetor		
Rishikimi vjetor	Vjetor	Dhjetor i çdo viti	Progresi ndaj TKP-ve, shpenzimet, mësimet e nxjerra	Raporti vjetor i progresit
Rishikimi afatmesëm	Një herë	Fund i vitit 2027 (pas Fazës I)	Vlerësimi i Fazës I, përgatitja e detajuar e Fazës II, korrigjime	Raport vlerësimi, plan i përditësuar
Rishikimi përfundimtar	Një herë	Fund i vitit 2030	Arritjet totale, mësimet e nxjerra, rekomandimet për periudhën pas 2030	Raporti përfundimtar i strategjisë

11.4 Metodologjia e monitorimit

11.4.1 Parimet e monitorimit

Monitorimi i zbatimit të strategjisë do të realizohet në mënyrë të standardizuar, sistematike dhe të verifikueshme. Procesi bazohet në tri parime kryesore: (i) mbledhja e rregullt e të dhënave nga burime të besueshme, (ii) analiza e pavarur dhe krahasuese ndaj targeteve, dhe (iii) raportimi transparent ndaj vendimmarrësve dhe publikut.

11.4.2 Burimet e të dhënave dhe përgjegjësitë

Mbledhja e të dhënave koordinohet nga Grupi Punues Komunal për Ujërat, në bashkëpunim me institucionet relevante. Tabela e mëposhtme përcakton burimet, llojet e të dhënave dhe frekuencën e mbledhjes.

Tabela 62.11.4 Metodologjia e monitorimit

Burimi i të dhënave	Lloji i të dhënave	Frekuenca	Përgjegjësia
KRU "Gjakova"	Të dhëna operative: prurjet e trajtuara, cilësia e shkarkimeve (BOD ₅ , COD, TSS), defektet në rrjet, shkalla e arkëtimit, incidentet operative	Mujore	Menaxheri i Njesisë Rahovec
Komuna – Drejtoria e Infrastrukturës	Progresi i investimeve kapitale, shpenzimet, kontratat, afatet e zbatimit	Tremujore	Drejtori i Infrastrukturës
Komuna – Drejtoria e Mjedisit	Lejet e lëshuara, inspektimet, masat ndëshkuese, regjistri i ndotësve	Tremujore	Drejtori i Mjedisit
Komuna – NJPZ	Incidentet e përmytjeve, dëmet materiale, reagimi emergjent, zonat e rrezikuara	Sipas ngjarjes + vjetore	Koordinatori i NJPZ
Komuna – Qendra për Shërbime	Ankesat e qytetarëve, kërkesat, afatet e trajtimit	Mujore	Përgjegjësi i QSH
AMMK	Cilësia e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në pikat e monitorimit	Vjetore (ose sipas disponueshmërisë)	AMMK – Sektori i Monitorimit
Komuniteti	Sondazhet e kënaqshmërisë, raportimet vullnetare të ndotjes	Vjetore	Komuna + OJQ

11.4.3 Procesi i analizës dhe raportimit

Të dhënat e mbledhura kalojnë nëpër një proces të strukturuar analize dhe raportimi, i cili siguron cilësinë e informacionit dhe mundëson vendimmarrje të informuar.

Tabela 63. Procesi i analizës dhe raportimit

Hapi	Aktiviteti	Përgjegjësia	Produkti	Afati
1	Mbledhja dhe verifikimi i të dhënave nga burimet	Sekretariati i Grupit Punues	Databaza e përditësuar	Deri në datën 10 të muajit pasues
2	Analiza e progresit ndaj KPI-ve dhe targeteve	Grupi Punues Komunal	Draft-raporti tremujor	Brenda 15 ditëve nga mbledhja
3	Rishikimi dhe miratimi i raportit tremujor	Grupi Punues (takimi)	Raporti tremujor final	Deri në fund të muajit pasues
4	Konsolidimi i raportit vjetor	Drejtoria e Infrastrukturës	Draft-raporti vjetor	Dhjetor i çdo viti
5	Shqyrtimi dhe miratimi nga Kuvendi Komunal	Kuvendi Komunal	Raporti vjetor i miratuar	Janar i vitit pasues

11.4.4 Publikimi dhe transparencia

Transparencia ndaj publikut dhe palëve të interesuara sigurohet përmes mekanizmave të mëposhtëm:

- **Publikimi në faqen zyrtare:** Raportet vjetore të miratuara publikohen në faqen e internetit të Komunës së Rahovecit, në seksionin e dedikuar për strategjinë e ujërave, brenda 15 ditëve nga miratimi.
- **Prezantimet publike:** Organizohen të paktën një herë në vit (pas miratimit të raportit vjetor) për të informuar qytetarët mbi progresin, arritjet dhe sfidat. Prezantimet mund të kombinohen me konsultimet publike për fazat e ardhshme.
- **Informimi i donatorëve:** Raportet e progresit u shpërndahen donatorëve aktivë sipas kërkesave të marrëveshjeve të financimit.
- **Akresi në të dhëna:** Qytetarët kanë të drejtë të kërkojnë informacion shtesë sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

1.4.5 Sigurimi i cilësisë së të dhënave

Për të garantuar besueshmërinë e të dhënave dhe raporteve, zbatohen masat e mëposhtme:

Masa	Përshkrimi
Standardizimi	Përdorimi i formularëve të unifikuar (Aneksi 4) për mbledhjen e të dhënave nga të gjitha burimet
Verifikimi	Kontrolli i dyfishtë i të dhënave kritike (p.sh. kosto, KPI) para përfshirjes në raporte
Gjurmueshmëria	Ruajtja e dokumentacionit mbështetës (faturat, procesverbalet, fotot) për të gjitha të dhënat e raportuara

Auditimi	Mundësia e auditimit të jashtëm të raporteve financiare sipas kërkesave të donatorëve ose Kuvendit Komunal
-----------------	--

11.5 Menaxhimi adaptiv

Strategjia do të zbatojë qasje adaptive që mundëson përshtatjen ndaj rrethanave të reja dhe mësimave të nxjerra gjatë zbatimit.

Parimet e menaxhimit adaptiv:

1. **Përditësimi i masave:** Bazuar në rezultatet e monitorimit, masat që nuk japin rezultate do të rishikohen dhe përshtaten.
2. **Riprioritizimi i investimeve:** Nëse ndryshojnë rrethanat (financimi, nevojat, problemet e reja), prioritetet e investimeve mund të ripërcaktohen.
3. **Integrimi i teknologjive të reja:** Kur teknologji më efikase bëhen të disponueshme, ato do të vlerësohen për integrim në sistem.
4. **Forcimi i kapaciteteve:** Bazuar në mësimet e nxjerra, trajnimet dhe procedurat do të përshtaten për të adresuar mangësitë e identifikuara.
5. **Shkëmbimi i përvojave:** Bashkëpunimi me komuna të tjera dhe organizata ndërkombëtare për të mësuar nga praktikat më të mira.




Figura 9. Cikli i menaxhimit adaptiv

12. REFERENCAT

1. Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës
2. Udhëzimi Administrativ Nr. 19/2015 për Veprimet e Dëmshme të Ujërave, MMPHI
3. Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturinat, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës
4. Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës
5. Strategjia Shtetërore për Ujërat e Kosovës 2022–2026, MMPHI, Prishtinë
6. Rishikimi i Strategjisë Shtetërore për Ujërat 2023–2027, MMPHI, Prishtinë
7. Plan i Zhvillimit Komunal i Rahovecit 2023–2031, Komuna e Rahovecit
8. Plan i Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM) 2019–2024, Komuna e Rahovecit
9. Plan i Menaxhimit të Mbeturinave për Komunën e Rahovecit 2016–2021, Komuna e Rahovecit
10. Plan i Veprimt për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë (SECAP), Komuna e Rahovecit
11. Rahovec Municipal Development Plan Strategic Environmental Assessment, UN-HABITAT, 2012
12. Master Plan i Trajtimit të Ujërave të Zeza për Zonat Rurale në Republikën e Kosovës, L. Osmanaj, Universiteti Politeknik i Tiranës, 2015
13. Raporti për Gjendjen e Mjedisit 2022, AMMK, Prishtinë
14. Raporti për Gjendjen e Ujërave në Kosovë 2020, AMMK, Prishtinë
15. Direktiva 91/271/EEC për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane, Bashkimi Evropian
16. Direktiva 2000/60/EC (Direktiva Kornizë për Ujërat), Bashkimi Evropian
17. Direktiva 2007/60/EC për Vlerësimin dhe Menaxhimin e Rreziqeve nga Përmblytjet, Bashkimi Evropian
18. Guidelines on Municipal Wastewater Management, UNEP, Shkurt 2004
19. Planning Guide to Developing a Wastewater Management Plan, Manitoba, Kanada
20. I. Nhapi, H.J. Gijzen, "The 3-Step Strategic Approach to Sustainable Wastewater Management", 2005
21. A. Barshai, "Wastewater Treatment", 2018
22. Të dhënat statistikore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), 2011–2022
23. Të dhënat operative të KRU "Gjakova", 2020–2023


ANEKSET

ANEKSI 1: LISTA E PLOTË E VENDBANIMEVE ME TË DHËNA PËR KANALIZIM DHE FURNIZIM ME UJË


Tabela 64. Lista e vendbanimeve (Komuna e Rahovecit): Kanalizim + Furnizim me ujë

Nr.	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Furnizimi me ujë – Sistemi	Furnizimi me ujë – Menaxhimi	Kanalizim
1	Rahovec	13,642	Publik	KRU Gjakova	Po
2	Bellacërkë	1,582	Publik	KRU Gjakova	Po – pjesërisht
3	Bërnjakë	32	Publik	KRU Gjakova	Po
4	Bratatin	265	Publik	KRU Gjakova	Po
5	Brestoc	704	Publik	KRU Gjakova	Po
6	Celinë	1,271	Publik	KRU Gjakova	Po
7	Çifllak	1,130	Publik	KRU Gjakova	Po
8	Dabidol	418	Publik	KRU Gjakova	Po
9	Dejnë	1,225	Publik	KRU Gjakova	Po
10	Drenoc	880	Pompim-Pusi	KRU Gjakova	Po
11	Gexhë	503	Publik	KRU Gjakova	Po
12	Hoçë e Madhe	508	Publik	KRU Gjakova	Po
13	Hoçë e Vogël	987	Publik	KRU Gjakova	Po
14	Kaznik	105	Individual	–	Jo
15	Kramovik	780	Publik	KRU Gjakova	Po
16	Krushë e Madhe	3,183	Publik	KRU Gjakova	Po
17	Mrasor	158	Individual	KRU Gjakova	Po
18	Nagave	623	Publik	KRU Gjakova	Po
19	Nashpall	186	Publik	KRU Gjakova	Po
20	Opterushë	1,091	Natyror	Burimi i fshatit (pompim autonom)	Po
21	Pastaselë	757	Publik	KRU Gjakova	Po
22	Pataqan i Epërm	244	Publik	KRU Gjakova	Po
23	Pataqan i Poshtëm	672	Publik	KRU Gjakova	Po
24	Petkoviq (Guri i Kuq)	746	Publik	KRU Gjakova	Po
25	Polluzhë	517	Publik	KRU Gjakova	Po
26	Radostë (Malësi e Vogël)	1,507	Publik	KRU Gjakova	Po
27	Ratkoc	2,713	Publik	KRU Gjakova	Po
28	Reti e Poshtme	170	Publik	KRU Gjakova	Po
29	Retijë	492	Publik	KRU Gjakova	Po
30	Sapniq	525	Publik	KRU Gjakova	Po
31	Sarosh	0	Publik	KRU Gjakova	Po
32	Senoc	585	Natyror-Pusi	KRU Gjakova	Po
33	Vrajakë	625	Publik	KRU Gjakova	Po
34	Xërxë	2,378	Publik	KRU Gjakova	Po
35	Zatriq	196	Burim vetanak	Burimi i fshatit (kaptazh + pompim)	Po
36	Zaqishë	399	Burim vetanak	Burimi i fshatit (pompim autonom)	Po


ANEKSI 2: HARTAT TEKNIKE



Harta A2-1. rrjeti i ujësllësit – Furnizimi me ujë të pijshëm



Harta A2-2. rrjeti i kanalizimit – Qasja në rrjetin e kanalizimit



Harta A2-3. zonat me rrezik të lartë nga përmytjet në Komunën e Rahovecit

ANEKSI 3: TERMAT E REFERENCËS PËR STUDIMET E FIZIBILITETIT

A3.1 Hyrje

Ky aneks përcakton kornizën orientuese për hartimin e Termave të Referencës (ToR) për tri studimet kryesore të fizibilitetit që mbështesin zbatimin e Strategjisë për Menaxhimin e Ujërave të Zeza në Komunën e Rahovecit 2025–2031. Termat e detajuara do të finalizohen nga Komuna në bashkëpunim me KRU "Gjakova" dhe donatorët, sipas kërkesave specifike të prokurimit.

A3.2 Studimet e planifikuara

Tabela A3.1. Përmbledhja e studimeve të fizibilitetit

Kodi	Studimi	Fokusi	Afati	Buxheti orientues (€)
ToR-1	WWTP Rahovec + Kolektorët Urbanë	Zona urbane, ~15,000 BE	4–6 muaj	50,000–80,000
ToR-2	WWTP Krushë e Madhe & Gexhë + Kolektorët Ruralë	Zonat rurale, ~8,000 BE	4–5 muaj	40,000–60,000
ToR-3	Studimi Hidrologjik/Hidraulik për Përmytjet	Drenazhimi dhe menaxhimi i rrezikut	3–4 muaj	30,000–45,000

A3.3 ToR-1: Fizibiliteti për WWTP Rahovec dhe Kolektorët Urbanë

Qëllimi: Vlerësimi i zgjidhjes optimale teknike dhe ekonomike për ndërtimin e Impiantit të Trajtimin të Ujërave të Ndotura (WWTP) në Rahovec dhe rrjetit urban të kolektorëve.

Tabela A3.2. Objektivat dhe dorëzimet për ToR-1

Objektivat kryesore	Dorëzimet (Deliverables)
• Analiza e gjendjes ekzistuese të kanalizimit dhe pikave kritike të shkarkimit	• Raporti i Fizibilitetit me alternativat dhe rekomandimin (CAPEX/OPEX, kosto për m ³ dhe për PE)
• Vlerësimi i kërkesës (PE), projeksioneve të popullsisë dhe ngarkesës ndotëse (BOD ₅ /COD/TSS)	• Projekt-koncept: skema e procesit, layout, dimensionime orientuese
• Identifikimi dhe vlerësimi i alternativave të lokacionit (shpronësim, distanca, qasja)	• Plan i kolektorëve kryesorë (trase, diametra, stacione pompimi)
• Krahasimi i teknologjive (SBR, MBBR, laguna të përmirësuara) me OPEX/CAPEX	• Vlerësim mjedisor paraprak (screening) dhe lista e lejeve
• Projektimi konceptual i WWTP dhe kolektorëve kryesorë	• Plan i fazimit 2025–2031 dhe plan i prokurimit

A3.4 ToR-2: Fizibiliteti për WWTP Rurale dhe Kolektorët Ruralë

Qëllimi: Vlerësimi i opsioneve më të përshtatshme për trajtimin e ujërave të ndotura në zonat rurale, me fokus në Krushë e Madhe dhe Gexhë.

Tabela A3.3. Objektivat dhe dorëzimet për ToR-2

Objektivat kryesore	Dorëzimet (Deliverables)
• Inventarizimi i vendbanimeve të synuara, rrjetit ekzistues dhe pikave të derdhjes	• Raporti i Fizibilitetit për alternativat (teknologji + lokacion + kolektorë)
• Përllogaritja e ngarkesave sipas vendbanimeve; skenarët: impiant i përbashkët vs. të ndarë vs. zgjidhje natyrore	• Projekt-koncept për WWTP (Krushë e Madhe, Gexhë) dhe kolektorët e lidhjes
• Vlerësimi i terrenit dhe kushteve hidrogeologjike	• Plan i fazimit dhe lista e prioritetëve sipas ndikimit në reduktimin e shkarkimeve

• Projektimi konceptual i kolektorëve ruralë (gravitet/pompim)	• Vlerësimi i rrezikut (shpronësim, përmytje, kosto operimi)
• Analiza e qëndrueshmërisë operacionale (O&M, energji, mirëmbajtje)	• Analiza e kostove dhe opsionet e financimit

A3.5 ToR-3: Studimi Hidrologjik/Hidraulik për Përmytjet

Qëllimi: Analiza e rrezikut nga përmytjet dhe projektimi i masave të drenazhimit për të ulur dëmet materiale në zonat e identifikuara si të rrezikuara.

Tabela A3.4. Objektivat dhe dorëzimet për ToR-3

Objektivat kryesore	Dorëzimet (Deliverables)
• Mbledhja e të dhënave hidrometeorologjike (reshje, prurje, ngjarje historike)	• Raporti teknik i modelimit + hartat GIS të rrezikut
• Modelimi hidrologjik/hidraulik (HEC-HMS/HEC-RAS) për periudha kthimi 10/20/50 vite	• Lista e masave me kosto orientuese dhe prioritet (shkalla e rrezikut)
• Identifikimi i pikave kritike (urëza, kanale të ngushta, kolektorë të tejmbushur)	• Plan i mirëmbajtjes dhe përgjegjësisë institucionale
• Projektimi konceptual: zgjerim kanalesh, basene retencioni, rregullim shtrati	• Përmbledhje ekzekutive 2–3 faqe për vendimmarrësit

Zonat prioritare për ToR-3: Fortesë (Bellacërkë), Xërxë, Celinë, Krushë e Madhe, Çifllak, Dejnë, Ratkoc, Radostë, Gexhë, Nënqyteti i Rahovecit.

A3.6 Kërkesat e përbashkëta për të gjitha studimet

Kualifikimet e konsulentit:

- Përvojë e dokumentuar në projekte të ngjashme në Kosovë ose rajon (≥3 projekte të krahasueshme)
- Ekip multidisiplinar: inxhinierë mjedisorë, hidroteknikë, ekonomistë, specialistë socialë
- Njohja e legjislacionit vendor (Ligji për Ujërat, UA 19/2015) dhe Direktivës 91/271/EEC

Standardet e raportimit:

- Raportet në gjuhën shqipe (me përmbledhje në anglisht për donatorët)
- Format i dixhital (PDF + Word/Excel) dhe 3 kopje fizike
- Hartat në format GIS (shapefile) të pajtueshme me sistemin e Komunës

Afati i vlefshmërisë së studimeve: 5 vjet nga data e miratimit (me mundësi përditësimi)

A3.7 Procesi i miratimit

Hapi	Aktiviteti	Përgjegjësia
1	Finalizimi i ToR-ve të detajuara	Komuna + KRU
2	Konsultimi me donatorët (nëse financohet nga grantet)	Komuna
3	Prokurimi i konsulentit	Komuna (sipas LPP ose procedurave të donatorit)
4	Zbatimi i studimit	Konsulenti
5	Rishikimi dhe miratimi	Grupi Punues Komunal + KRU
6	Prezantimi për vendimmarrësit	Konsulenti + Komuna

Ky aneks shërben si kornizë orientuese. Termat e detajuara të referencës do të hartohen për secilin prokurim në përputhje me procedurat e aplikueshme dhe kërkesat e donatorëve.

ANEKSI 4: FORMULARËT PËR RAPORTIM DHE MONITORIM

F-1. Raporti Tremujor i Progresit

Periodha raportuese: ____ / ____ /202__ deri ____ / ____ /202__
Institucioni raportues: ☐ Komuna e Rahovecit ☐ KRU "Giakova" ☐ Tjetër: ____
Përgatiti: ____ Data: ____ / ____ /202__ ;

Kodi	Masa/Investimi	Statusi	%	Afati (plan)	Afati (real)	Kosto plan (€)	Kosto real (€)	Burimi	Vërejtje
		☐ Nisur ☐ Proces ☐ Fund							
		☐ Nisur ☐ Proces ☐ Fund							
		☐ Nisur ☐ Proces ☐ Fund							

Përmbledhje: Arritjet: _____

Pengesat: _____

Veprimet për tremujorin e ardhshëm: _____

F-2. Raporti Vjetor i Treguesve të Performancës (KPI)

Viti raportues: 202__ ; Përgatiti: _____ Data: ____/____/202__ ;

Treguesi (KPI)	Njësia	Vlera bazë	Vlera aktuale	Target 2031	Trendi	Burimi	Koment
Popullsia me trajtim	%			≥80%	↑/→/↓		
Cilësia BOD ₅	mg/L			≤25	↑/→/↓		
Km rrjet i rehabilituar	km	0		≥15	↑/→/↓		
Mbledhja e tarifave	%			≥85%	↑/→/↓		
Investimet e realizuara	€	0		17.5M	↑/→/↓		

F-3. Formulari i Raportimit të Incidentit (brenda 48 orëve)

Data/Ora e incidentit: ____/____/202__ Ora: ____ : Vendndodhja: _____

Lloji: ☐ Përmbytje ☐ Vërshim kanalizimi ☐ Rrjedhje/defekt ☐ Ndojje ☐ Tjetër: _____

Përshkrimi: _____

Dëmi i vlerësuar: _____ € ; Metoda: ☐ Vlerësim komunal ☐ Sigurim ☐ Tjetër

Masat urgjente të marra: _____

Nevojat për ndërhyrje afatmesme: _____

Bashkëngjijtje: ☐ Foto ☐ Koordinata GPS ☐ Dokumente tjera

F-4. Regjistri Mijor i Ankesave të Qytetarëve

Muaji/Viti: /202 ; Njësia: Përgatiti:

Nr.	Data	Kanali	Tema	Statusi	Data zgjidhjes	Ditë	Përgjegjësi
		☐ Tel ☐ Email ☐ Zyrë	☐ Ujë ☐ Kanalizim ☐ Përmbytje	☐ Hapur ☐ Mbyllur			
		☐ Tel ☐ Email ☐ Zyrë	☐ Ujë ☐ Kanalizim ☐ Përmbytje	☐ Hapur ☐ Mbyllur			

Afati standard i përgjigjes: 15 ditë pune | Totali i ankesave: | Të zgjidhura: (____%)

ANEKSI 5: LISTA E KONTAKTEVE TË INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE

A5.1 Qëllimi

Ky aneks identifikon institucionet kyçe për zbatimin e strategjisë, koordinimin, lëshimin e lejeve, monitorimin dhe reagimin ndaj emergjencave në Komunën e Rahovecit. Lista përditësohet çdo vit nga Koordinatori i Strategjisë.

Data e përditësimit të fundit: ____/____/202____

A5.2 Kontaktet institucionale

Tabela A5.1. Lista e kontakteve të institucioneve përgjegjëse

Institucioni	Njësia/Departamenti	Roli në Strategji	Personi kontaktues	Email	Telefon
NIVELI LOKAL					
Komuna e Rahovecit	Drejtoria e Infrastrukturës	Koordinim i zbatimit, projekte, investime			
Komuna e Rahovecit	Drejtoria e Mjedisit	Lejet mjedisore lokale, monitorimi			
Komuna e Rahovecit	Drejtoria e Urbanizmit	Leje ndërtimi, pajtueshmëri planore			
Komuna e Rahovecit	Drejtoria e Financave	Buxhetimi, bashkëfinancimi			
Komuna e Rahovecit	NJPZ (Mbrojtje dhe Shpëtim)	Reagim ndaj përmbytjeve, emergjencat			
Komuna e Rahovecit	Qendra për Shërbime të Qytetarëve	Ankesat, komunikimi me publikun			
KRU "Gjakova"	Njësia operative Rahovec	Operim/mirëmbajtje kanalizim dhe WWTP			
NIVELI KOMBËTAR					
MMPHI	Departamenti i Ujërave	Politikat, standardet, bashkëfinancimi			
AMMK	Spektori i Monitorimit të Ujërave	Monitorim cilësie, inspektime, leje			
ARRU	—	Rregullimi i tarifave, performanca e KRU			
IHMK	—	Të dhënat hidrometeorologjike, paralajmërimet			
INSTITUCIONE MBËSHTETËSE					
Agjencia Kadastrale	Zyra lokale Rahovec	Shpronësimi, regjistrimet pronësore			
Policia e Kosovës	Stacioni Rahovec	Mbështetje në emergjencat			
Zjarrfikësit	Njësia Rahovec	Reagimi ndaj përmbytjeve/emergjencave			
